

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

FSHEHTËSITË E PASTËRTISË

Imam Gazali

Prishtinë, 2018

Ihjau Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i originalit
Kitabu esrari't-tahare
Libri 3

Përgatiti dhe përktheu
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor
Sezai Sylejmani

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Falënderim (*hamd*) Allahut Teala, që me mirësinë e Tij i begatoi robët e Tij, e këta me pastrim i bëjnë ibadet; ua mbushi zemrat me nurin dhe rahmetin e Tij që ta pastrojnë të brendshmen e tyre, dhe ua caktoi ujin, të mirë e të këndshëm, që ta pastrojnë të jashtmen e tyre.

Salavat e selam Resulallahut s.a.v.s., që me nurin e udhëzimit i mbushi zemrat në të gjitha anët e botës, e edhe ehli-bejtit të tij, të mirë e të ndershëm, e bereqeti i këtij salavati do të na jetë shpëtim dhe mbrojtje në Ditën e frikës, dhe do të jetë pengesë mes nesh dhe gjithçkaje që nuk është e mirë.

E pas kësaj dije se, Resulallahu s.a.v.s., thotë:
“Feja, është e ndërtuar mbi pastërti.”¹, dhe

“Çelësi i namazit është pastërtia.”²

¹ Hadithi nuk është gjetur në këtë formë. Në veprën *ed-Duafa* nga Ibn Hibban, përmendet hadithi nga Ajshe r.anha:

“Pastrohuni, sepse islami është i pastër”.

Taberani e shënon në *el-Evsat* me zinxhir shumë të dobët, nga Ibn Mesud: **“Pastrimi çon në besim”.**

² Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, nga Alia r.a.. Tirmidhiu ka thënë: **“Ky është hadithi më i besueshëm për pastërtinë.”**

Allahu Teala thotë:

“Një xhami e cila që prej ditës së parë është themeluar në respekt ndaj Allahut (Kuba),... aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen shumë. Allahu i do ata që pastrohen shumë.” 9-Teube: 108

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Pastërtia është gjysma e imanit.”³

Allahu Teala thotë:

“Allahu nuk dëshiron t’ju krijojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’ju pastrojë dhe t’i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues.” 5-Maide: 6

Nga këto ajete dhe hadithe të qarta, poseduesit e basiretit (mendjemprehtët) e kuptojnë se pastrimi i brendshëm është më i rëndësishëm, sepse është e papranueshme që me fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

“Pastërtia është gjysma e imanit”,

të mendohet në pastrimin e të jashtmes me ujë, e të shpërfillet e brendshmjia dhe të lihet e mbushur me papastërti.

³ Tirmidhiu, nga një person i fisit Ebu Sulejm, dhe thotë që është *hadith hasen*, e Muslimi nga Ebu Malik el-Esh’shariu, e në vend të fjalës *nisf* përdoret fjala *shatr*.

E pastërtia, i ka katër gradë:

1. *Pastrimi pas kryerjes së nevojës, pas ejakulimit, pas marrëdhënies intime dhe pas ndyrësisë;*
2. *Pastrimi i pjesëve të trupit nga veprat e këqija dhe gjynahet;*
3. *Pastrimi i zemrës nga tiparet e shëmtuara dhe veset e neveritshme; dhe*
4. *Pastrimi i të brendshmes nga masiva (gjithçka pos Allahut) - e ky është pastrimii pejgamberëve dhe sidikkëve.*

Pastrimi në secilën prej këtyre gradave, është gjysmë veprimi në atë gradë, e qëllim final i veprave që kanë të bëjnë me të brendshmen është njohuria hyjnore (*marifet*). Njohja e vërtetë e Allahut Teala nuk është e mundur përderisa në brendësi të njeriut ka diçka tjetër përpos Allahut. Prandaj Allahu Teala thotë:

“Thuaj: ‘Allahu’. Mandej lëri ata që luajnë në atë kotësinë e tyre.”6-Enam: 91,

sepse njohja e vërtetë është në kundërshtim me prirjen për dynjallëk dhe nuk mund të jenë bashkë në një zemër. E,

“Allahu nuk i ka dhënë asnjë njeriu dy zemra në kraharor.” 33-Ahzab: 4

Qëllimi final i veprimit të zemrës është që ai veprim ta mbushë zemrën me moral të bukur dhe me besim të drejtë sipas përcaktimit të shariatit, e zemra nuk do të jetë sipas përcaktimit të shariatit deri sa nuk pastrohet nga e kundërta e kësaj, që është besimi i prishur dhe veset e shëmtuara. Me këtë shpjegim kuptohet që imani ka dy pjesë: një pjesë është pastrimi i zemrës, e tjetra është mbushja e saj me moral të bukur dhe besim të drejtë. Pjesa e parë - pastrimi i zemrës, është kusht i imanit. Njëjtë me gjymtyrët; pastrimi i tyre nga gjynahet është pjesa e parë nga dy pjesët e veprimit. Pjesa e dytë, ibadeti, nuk bëhet me gjymtyrë që nuk janë pastruar nga gjynahet. Sipas kësaj, pjesa e parë - pastrimi i gjymtyrëve nga gjynahet, bëhet kusht i veprimit.

Pra, këto janë grada të imanit, e në secilën gradë, personi mund të kalojë në shkallë më të lartë vetëm pasi të ketë kaluar shkallën më të ulët.

Zemra nuk pastrohet përderisa nga ajo nuk largohen besimi i prishur dhe veset e këqija e të mbushet me nurin e tevhidit dhe me moral të bukur. Sa më i lartë e fisnik të jetë qëllimi, rruga deri atje bëhet më e gjatë dhe më e vështirë. Mos mendo se kjo mund të arrihet pa vështirësi e me dëshira të bukura. Personi dritë-shkurtër që nuk mund të shohë dallimet mes këtyre shkallëve, nuk do të jetë në gjendje të kuptojë pjesët e përmendura të pastrimit; ai e braktisë esencën dhe merret me lëvozhgë.

I këtilli, nga pastrimi kupton vetëm të jashtmen (pastrimin e trupit) dhe tërë kohën ia kushton pastrimit pas nevojës dhe larjes së trupit e rrobave, duke harxhuar shumë ujë - e që është vesvese e shejtanit dhe kuptim i gabueshëm gjoja se ky është pastrimi i duhur dhe i vërtetë. I këtilli nuk i di tregimet e të parëve tanë, që ishin singërisht të preokupuar me pastrimin e zemrës, e nuk brengoseshin shumë për të jashtmen:

Hazreti Omeri r.a., edhe pse kishte pozitë të lartë në mesin e as'habëve, ka marrë abdes me ujë nga ena e një të krishtereje. Bile, pas ngrënies as'habët duart i kanë fshirë për tabanin e këmbës, e për pastrim nuk kanë përdorë *çogen*,⁴ namazin e falnin në tokë, e në rrugë ecnin këmbëzbathur. Më të respektuarit mes tyre ishin ata që, kur flenin, nuk kishin shtrojë nën vete, e për taharet përdornin gurë dhe nuk hargjonin kohë për të kërkuar ujë.⁵ Ndërsa Ebu Hurejre ka treguar:

“Nganjëherë qëllonim duke ngrënë mish të pjekur kur muezini thërriste ikamet, e ne ngriteshim, i fërkonim gishtat mes gurëve të vegjël ose me zallë, dhe menjëherë bënim tekbir e hynim në namaz”,

e thënie të ngjashme janë shënuar edhe nga *as'habi suff*.⁶

⁴ Bimë që perdorej për pastrimin e duarve.

⁵ Kjo vlen për shkretëtirë dhe vende ku nuk ka ujë, e nuk vlen për nevojtoare dhe vendet ku ka ujë.

⁶ As'habë të varfër e beqarë që qëndronin në një çadër buzë *Mesxhidi Nebevi*, e mësonin dituri nga Resulallahu s.a.v.s.

Omeri r.a., ka thënë:

“Në kohën e Resulallahut s.a.v.s., nuk kemi përdorë çogen për pastrim por përdornim pjesën e brendshme të shputave tona,⁷ dhe kështu i pastronim duart kur hanim ushqim të yndyrshëm.”

Dhe thuhet se pas Resulallahut s.a.v.s., katër gjëra janë risi: sofrja, sita, ngopja (ngrënia e tepërt) dhe çogeni. Gjithë qëllimi i të parëve ishte pastrimi i së brendshmes. Disa bile kanë thënë:

“Namazi me sandale është më me vlerë, sepse Resulallahu s.a.v.s., i zbathi sandalet në namaz pasi kështu e këshilloi Xhebraili a.s., për shkak që në to kishte papastërti,”⁸, por kur edhe të tjerët u zbathën, Resulallahu s.a.v.s., pyeti:

- Përse i zbathi sandalet?

Për ata që i zbathin sandalet, en-Nehai thotë:

“Sikur të vijë dikush që ka nevojë për sandale, e t’ju marrë!”, duke shprehur kështu mospajtimin e vet me këtë veprim.

Por, ata ishin tolerantë në këtë çështje, bile disa këmbëzbathur ecnin e uleshin edhe nëpër rrugë dhe në xhami faleshin mbi dhé. Për ushqim përdornin miellin nga thekra dhe elbi, që i bluanin me kuaj e deve, e që kafshët e bënin pis.

⁷ Nuk është gjetur nga Ibn Omeri, por Ibn Maxhe shënon hadith të ngjashëm në formë më të shkurtë, nga Xhabiri.

⁸ Shënojnë Ebu Davudi dhe Hakimi, duke e konsideruar të besueshëm, nga Ebu Seid el-Hudri.

Nuk ruheshin as nga djersa e devesë dhe kalit, ani pse ato shtriheshin në tokë. Asnjëri prej tyre nuk reagonte nëse kishte ndonjë sasi të vogël të papastërtisë. Me këtë ishin tolerantë.

E sot, (495 hixhri) ka njerëz të tillë që përshtatjen e dëshirave të nefsit e quajnë *pastërta* (nezafet), thanë se ky pastrim është esenca e fesë. Kalojnë shumë kohë duke zbukuruar të jashtmen, mu sikur nusja për dasëm, deri sa e brendshmjia e tyre është e mbushur me papastërti, vetë-pëlqim, padituri, lavdërim dhe dyfytërsi. Atyre kjo nuk ju duket e shëmtuar e as nuk mundohen t'i përmirësojnë këto cilësi të brendshme. E sikur dikush të pastrohet pas nevojës (*taharet*) me gur, të ecë këmbëzbathur në dhé, të falet në tokë ose në xhami pa sexhade apo shtrojë tjetër, ose të ecte pa pantofla e çorapë nëpër tepih, të marrë abdes nga ena e ndonjë të krishteri, do ta sulmonin ashpër, do t'i gjykonin këto veprime, do ta quanin të pistë dhe do ta largonin nga tubimet, bile edhe nga sofrat e tyre. Veshjen dhe sjelljen modeste, e që vjen nga besimi, ata e quajtën pisllek, ndërsa zbukurimet e tyre që vinë nga nefsi i llogarisin si pastërti.

Shih se si e shëmtuara dhe e përbuzura u bënë të mira, ndërsa ajo që është e mirë dhe e lavdërueshme u shndërrua në të shëmtuar, dhe si humbën gjurmët e hakikatit të fesë e diturisë, dhe si rregullat e sjelljes me lehtësi u ndryshuan.

E nëse ti pyet:

“A mendoni se praktika e re e sufive në veshje, pastrim dhe pamjen e jashtme është diçka e ndaluar apo e papëlqyer?”,

unë them se nuk është e drejtë të japim gjykim të prerë pa e sqaruar mirë këtë çështje. Por dua ta them këtë:

enët dhe mjetet për pastrim, mbathja e çorapeve, veshja e mantelit për mbrojtje nga pluhuri e të ngjashme janë të lejuara (*mubah*), e varësisht nga qëllimi ose rrethanat, nganjëherë mund të jenë edhe të papëlqyeshme (*munker*).

Kur them se janë të lejuara (*mubah*), është e njohur që secili ka të drejtë lirshëm ta përdorë pronën e vet, me kusht që të mos e shkapërderdh.

Të papëlqyeshme bëhen nëse sipas hadithit:

“Feja, është e ndërtuar mbi pastërti”,

personi e pranon këtë si themelt ë fesë dhe vishet si të parët, e me pastrim synon zbukurimin e pamjes së jashtme për pozitë në shoqëri, dhe kjo atëherë bëhet *rijallëk*, që është i ndaluar.

E veprim i lejuar bëhet nëse me të synohet qëllim i mirë, e jo zbukurimi, nëse me të nuk cenohet tjetri, nëse për të nuk shtyhet namazi, nëse për të nuk braktiset diçka më e rëndësishme, nëse me të nuk largohet nga angazhimi në dituri apo ndonjë vepër tjetër e dobishme.

Nëse nuk gjendet ndonjë pengesë e tillë, atëherë ky pastrim i jashtëm është i lejuar, dhe bashkë me nijetin, bëhet ibadet, por zbukurime të tilla janë për ata që bëjnë ibadet me dembeli, sepse të tillët do ta kalonin kohën në gjumë apo në biseda të kota. Në aso raste angazhimi me nijet të sinqertë në pastrimin e jashtëm do të ishte më i mirë, sepse me një veprim të tillë ripërtërihet kujtimi i Allahut Teala dhe i ibadeteve, prandaj edhe lejohet, deri sa nuk kalon në vepër të papëlqyer ose nuk teprohet.

Megjithatë, ata që dinë dhe që veprojnë me atë që dinë nuk do të duhej të humbasin kohë me këtë, përpos sa është e domosdoshme. Për ta, koha është margaritari më i çmueshëm. Harxhimi i tepërt i kohës në këtë për ta do të ishte veprim i shëmtuar. Kjo nuk është aspak e pazakontë, sepse veprimet që llogariten sevap për robët e mirë mund të jenë gjynah për *mukarrebun*-ët (robët e afërt me Allahun Teala).

Ata që janë dembelë në ibadet duke braktisur këtë lloj pastërtie, nuk kanë të drejtë të sulmojnë sufitetë të cilët thonë se po i pasojnë as'habët, sepse pasimi i as'habëve do të thotë angazhim në atë që është më e rëndësishme dhe më parësore.

Kur e pyetën Davud-i Tainë pse nuk e krehë mjekrën, aiu përgjigj:

“Sepse kam obligime tjera”.

Prandaj mendoj që dijetari, nxënësi dhe abidët nuk do të duhet të harxhojnë kohë në larjen e rrobave me frikë se dikush tjetër nuk do t'jua lajë mirë.

Sepse të parët tanë falnin namazin me rroba nga gëzofi, dhe nuk është e njohur që ndonjëri prej tyre të ketë bërë dallim mes rrobave që lahen dhe atyre nga gëzofi. E anashkalonin dhe largonin papastërtinë kudo që e shihnin, e nuk e zgjasnin. Por kishin shumë kujdes për detajet më të vogla të rijallëkut e padrejtësisë. Deri sa Sufjan Sevri ecte me një miknë rrugët të Kufes, miku i tij e shikoi hyrjen e një shtëpie të madhe e të rregulluar bukur. Sufjani i tha:

- Mos shiko. Po të mos shikonin njerëzit kështu, as ky nuk do të harxhonte kaq shumë. Kush e shikon atë shtëpi, po e ndihmon pronarin në harxhime të kota.

Ata mendonin për çështje të këtilla, jo për detaje të vogla të papastërtisë. Sikur dijetari të gjejë një person të zakonshëm që t'ia lajë rrobat dhe të kujdeset për këtë, do të ishte mirë. I këtilli do të kishte dobi, sepse nefsi i tij, që e udhëzon për të keqe, do të angazhohej në punë të lejuar dhe do të përmbahej nga gjynahet, e nëse nefsi nuk angazhohet në asgjë, ai do ta angazhojë njeriun në të keqe. Nëse personi me këtë punë dëshiron të arrijë afërsinë e dijetarit, kjo do t'i ishte një ndër veprat e mira më të vlefshme. Koha e dijetarit është aq me vlerë, sa nuk duhet ta harxhojë në këso veprime, e për personin e zakonshëm më së miri do të ishte që kohën ta harxhojë pikërisht në këso veprime.

Nga kjo do të kishte dobi të shumëfishtë për secilin, prandaj le të mendohet për këso dhe vepra të ngjashme, si edhe për vlerat dhe përparësitë e tyre. Kujdesi për secilin moment të jetës dhe drejtimi i vëmendjes në atë që është më e mirë dhe më e vlefshme, është më me rëndësi se sa angazhimi me këtë dynja.

Nëse e ke kuptuar këtë hyrje, atëherë e ke kuptuar se pastërtia i ka katër gradë, e në këtë libër do të flasim vetëm për gradën e katërt, pra për pastërtinë e jashtme (*zahir*), siç e cekëm në fillimin e librit.

Ne themi që pastërtia e jashtme mund të shpjegohet në tre kapituj, e ato janë:

1. Pastrimi nga pislëku;
2. Pastrimi nga gjendjet e papastra (*hades*); dhe
3. Pastrimi i tepricës që del nga trupi, pastrimi i thonjëve, pastrimi i qimeve nën sqetull dhe në vendet e turpshme, synetia e të ngjashme.

Kapitulli i parë RRETH PASTRIMIT NGA PISLLËQET

Pastrimi nga pislleqet i ka tri pjesë:

1. Ajo që largohet me pastrim;
2. Mjetet për pastrim; dhe
3. Mënyrat e largimit të papastërtisë.

AJO QË LARGOHET ME PASTRIM

Kjo është papastërtia materiale. Së pari duhet të dihet se materia është tri llojesh: jo e gjallë, e gjallë dhe si pjesë e gjallesave.

Gjithçka nga materia jo e gjallë është e pastër, përpos alkoolit dhe gjithçka që dehë.

Nga materia e gjallë, të gjitha kafshët konsiderohen të pastra, përpos qenit e derrat dhe këlyshëve të tyre. Por kur vdesin, të gjitha kafshët janë të papastra, përpos njeriut, peshkut, karkalecit dhe krimbit të mollës, e aty bën pjesë edhe gjithçka që nuk mund të përdoret si ushqim dhe gjithçka që nuk rrjedh gjak, siç janë mizat, bubat e të ngjashme. Prandaj, nëse në ujë bie diçka nga këto, uji nuk do të bëhet i papastër.

E pjesë të kafshëve ka dy llojesh:

a) *Pjesët që prehen nga kafsha.*

Këtu vlejné rregullat për kafshën e ngordhur; qimeja nuk bëhet e papastër me qethje a me ngordhjen e kafshës, e eshtrat janë të papastër; dhe

b) *Ajo që del e lagur nga brendësia e kafshës.*

Gjithçka që mbledhet në brendësinë e kafshës e del jashtë nga aty pa u shndërruar në diçka tjetër është e pastër, siç janë lotët, djersa, pështyma etj.

Gjithçka që mbledhet në brendësinë e kafshës e del jashtë nga aty pasi është shndërruar në diçka tjetër, është e papastër, pos asaj nga vet materia e kafshës, siç është sperma a vezët. Të papastra janë qelbi, gjaku, bajga dhe urina e të gjitha kafshëve.

Papastërtia lejohet vetëm në pesë raste:

1. gjurma e jashtëqitjes pas pastrimit të së pasmes me gurë, e nuk i kalon kufijtë e hapjes anale;
 2. balta nga rrugë dhe pluhuri nga bajga; ani pse bajga është e papastër, tolerohet nëse i është ngjitur përkundër kujdesit;
 3. papastërtia nga rruga nën këpucë që mbetet pas fërkimit dhe fshirjes;
 4. papstërtia nga insektet, që nuk kalon kufijtë e të zakonshmes në rrobën e veshur; dhe
 5. gjaku, qelbi a lëngu që del nga puçrra.
- AbdullahIbn Omeri r.a., e shtrydhi një puçërr në fytyrë e i doli gjak, dhe fali namaz pa e pastruar.

Këtu bëjnë pjesë edhe njollat nga puçrra që shfaqen me derdhjen e lëngut, e që zakonisht zgjasin, si edhe gjurmët që mbesin pas lëshimit të gjakut, përpos infektimit dhe plagëve, që nuk është puçërr e zakonshme; e kjo trajtohet njëjtë si *istihaza*. Tolerimi i këtyre pesë papastërtive na flet për fleksibilitetin e sheriatit sa i përket pastërtisë, ndërsa gjithçka jashtë kësaj është vetëm vesvese e shejtanit, pa kurrfarë baze.

MJETET PËR PASTRIM

Mjetet që pastrojnë mund të jenë në gjendje të ngurtë apo të lëngët.

Mjetet në formë të ngurtë mund të jenë gurët e pastër, të tharë e të pavlefshëm, me të cilët mund të bëhet pastrimi pas nevojës së madhe.

Sa për mjetet në formë të lëngët; me asgjë nuk pastrohet fëlliqësia përpos ujit, me kusht që uji të jetë i pastër, që nuk humb cilësitë e veta me përzierje nga ndonjë materie. Uji bëhet i papastër nëse përzihet me fëlliqësi, nëse ndryshon shijen, ngjyrën apo aromën. Nëse nuk vjen deri te ndryshimi, e sasia e ujit nuk është nën pesëqind *ritle irakiane* (rreth 12 litra), atëherë është i pastër, sepse Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur uji të jetë në sasi sa dy kova, ai nuk mban papastërti.”⁹

⁹E shënojnë autorët e *Sunen-it*, Ibn Maxhe dhe el-Hakim, që e konsideron të besueshëm nga Ibn Omeri r.a..

Sipas mendimit të Imam Shafiut nëse sasia e ujit do të ishte më e vogël, uji bëhet i papastër. Kjo vlen për ujin që nuk rrjedhë, e te uji që rrjedhë e ndotet nga përzierja me papastërti, atëherë vala e ndotur do të jetë e papastër, por jo edhe vala përmbi ose nën të, sepse valët e ujit janë të ndara. Kjo vlen edhe për papastërtinë që rrjedhë, nëse rrjedhë në shtratin e ujit të rrjedhshëm; i papastër është vendi ku gjendet papastërtia dhe rrjedhat djathtas e majtas, nëse sasia e ujit është më e vogël se dy kova të mëdha. Nëse rrjedha e ujit është më e fortë se rrjedha e papastërtisë, atëherë e pastër është ajo që gjendet në rrjedhën e epërme (para ndotjes), ndërsa e papastër është ajo që gjendet në rrjedhën e poshtme të ujit (pas ndotjes), pa marrë parasysh gjatësinë, përpos nëse uji mblidhet në një vend në sasi të dy kovave të mëdha. Kur mblidhet ujë në këtë sasi, bëhet i pastër dhe nuk do të ndotet nëse spërkatet me ndotësi.

Ky është qëndrimi i Imam Shafiut, ani pse unë do të doja që mendimi i tij të jetë sikur i Imam Malikiut, i cili mendon se uji nuk do të ndotet deri sa nuk ndryshon me të madhe njëren nga tri cilësitë, për shkak se uji na është më se i domosdoshëm. Përcaktimi i sasisë me dy kova të mëdha shkakton vesvese, dhe për këtë kjo iu erdhi njerëzve e vështirë, e këtë mirë e dinë ata që janë sprovuar ose që mendojnë për këtë. Nuk ka dyshim që, po të kushtëzohej kjo, në Mekë e Medine do të ishte vështirë të mbahet pastërtia, sepse atje nuk ka ujë të mjaftueshëm, as të rrjedhshëm as që nuk rrjedhë.

E megjithatë, që nga koha e Resulallahut s.a.v.s., deri te fundi i kohës së as'habëve të tij nuk është shënuar asnjë ngjarje nga këto qytete që ndërlidhet me problemin e ruajtjes së pastërtisë, e as që dikush ka pyetur për mënyrën e ruajtjes dhe mbrojtjes së ujit nga papastërtia. Enët e tyre për ujë i mbanin e i bartnin fëmija dhe shërbëtoret, të cilët nuk kujdesen për pastërti. Omeri r.a., merrte abdes nga ena e një të krishtereje, e kjo është dëshmi e qartë që kriteri i tij kryesor për të konsideruar ujin të papastër ka qenë ndryshimi i njërës prej tri cilësive të ujit. Po të mos ishte kështu, lehtë ka mundur të mendojë në papastërtinë e të krishteres dhe të enës së saj.

Kështu, mos-parashtrimi i pyetjeve në kohën e tyre është *dëshmia e parë*, ndërsa sjellja e Omerit r.a., *dëshmia e dytë*.

Dëshmi e tretë është veprimi i Resulallahut s.a.v.s., që *e vendosi enën para maces*,¹⁰ e nuk i mbulonin enët as kur e shihnin macen duke ngrënë miun. Ata nuk kishin vende të posaçme ku macet pinë ujë, e ato në bunarë nuk janë lëshuar.

Dëshmia e katërt:

Imam Shafiu mendon se kur uji e largon ndotjen e nuk ndryshon është i pastër, por kur ndryshon, është i ndotur. Ku është dallimi, a e merr uji papastërtinë apo papastërtia e arrinë ujin? Çfarë kuptimi ka shprehja:

¹⁰ Taberani në *el-Evsat* dhe Darekutni nga Ajsha r.anha, ndërsa autorët e *Sunen-it* nga Ebu Katade.

“forca e rrjedhës së ujit e largon papastërtinë”,

kur kjo rrjedhë nuk e ndalë përzierjen e ujit me papastërtinë? Nëse arsyetohet me nevojën për ujë, epo - edhe nëse uji ndryshon, nevoja për të mbetet. Nuk ka dallim në mes të futjes së ujit në koritë me rroba dhe futjes së rrobave në koritën me ujë, e rrobat kështu pastrohen.

Dëshmia e pestë:

Pas nevojës fiziologjike, as’habët bënin *istinxa* (pastroheshin) në skajet e rrjedhave të vogla të ujit, e mendim unanim në medh’hebin shafi është se, nëse urina arrin ujin e rrjedhshëm e nuk ia ndryshon cilësitë, lejohet abdesi me atë ujë, pa marrë parasysh sasinë. Por atëherë, cili është dallimi mes ujit të rrjedhshëm dhe atij që qëndron? Do të doja ta di se çfarë është më e rëndësishme: siguria që uji nuk i ka ndryshuar cilësitë, apo forca e rrjedhës së ujit? Përpos kësaj, sa do të duhej të jetë fuqia e rrjedhës? A bëhet fjalë për rrjedhën e lumit apo edhe për rrjedhën e ujit nëpër kanale? Nëse nuk rrjedhë, atëherë ku është dallimi, e nëse rrjedhë - cili është dallimi mes asaj që bie në ujë dhe *ujit të ngrohtë* (urinës), që gjithashtu bie prej trupit? Pastaj, urina shpërbëhet më lehtë në ujë të rrjedhshëm sesa papastërtia e ngurtë.

Prandaj, le të themi se uji është i papastër kur në sipërfaqen e tij kalon papastërti e ngurtë por ujit nuk i ndërrohen cilësitë, dhe bëhet i pastër kur të mblidhet në një vend në sasi prej dy kovave të mëdha.

Por atëherë, cili është dallimi në mes të papastërtisë së ngurtë dhe asaj të lëngët në të njëjtin ujë, e shpërbërja e papastërtisë është më e vështirë se rrjedha e saj në ujë?

Dëshmia e gjashtë:

Nëse në ujin në sasi të dy kovave arrijnë rreth tri litra urinë, e më pas ajo sasi të ndahet, secila kovë e nxjerrë me ujë prej aty do të ishte e pastër, ndërsa dihet se urina shpërndahet edhe në sasi të vogël të ujit; do të doja ta di, a është ky ujë i pastër për shkak që uji nuk i ndryshon cilësitë apo për shkak që uji dominon edhe pasi që i është pakësuar sasia, ani pse jemi të sigurt që në të ende ka mbetje të papastërtisë?

Dëshmia e shtatë:

Në kohët e shkuara, njerëzit merrnin abdes në basenet e hamamit, i fusnin duart e i lanin edhe enët në to, ani pse aty ka pak ujë dhe e dinin se në atë ujë janë futur edhe duar të pastra edhe të papastra. Kjo na tregon nevojën e tyre të madhe për ujë dhe që, sigurisht, kusht për përdorimin e ujit ka qenë që ai të mos ndryshojë cilësitë, bazuar në hadithin:

“Uji është krijuar i pastër dhe asgjë nuk mund ta përlyejë, përderisa nuk e ndërron shijen, ngjyrën ose aromën..”¹¹

¹¹ Nga Ebu Umame me zinxhir të dobët të transmetuesve. Ebu Davudi, Nesai dhe Tirmidhiu nga Ebu Seid, por pa pjesën për ndryshim. Ebu Davudi e të tjerët e konsiderojnë të besueshëm.

Për këtë mund të thuhet: cilësi natyrore e secilit lëng është që gjithçka që futet në të, lëngu ia jep cilësitë e veta, dhe ajo dominohet nga lëngu. Prandaj, nëse një kafshë bie në shëllirë dhe e ndërron kripën, për atë kripë ende thuhet se është i pastër sepse ka mbetur ende kripë dhe në të nuk ka mbetur diçka nga kafsha. Njëjtë, nëse në ujë derdhet uthull ose një sasi e vogël e qumështit, dhe me këtë ujit i ndryshojnë cilësitë, ai edhe më tutje konsiderohet ujë, përpos kur shtesa e dominon ujin, e kjo dihet nëse ia dominon shijen, ngjyrën dhe aromën. Kjo është edhe masa e shariatit për ujin që e largon papastërtinë, dhe në këtë mund të mbështetet e të pastrohet. Me këtë vjen në shprehje edhe kuptimi i pastërtisë së ujit, sepse kur uji dominon, ai edhe pastron, njëjtë kur uji e kalon sasinë prej dy kovave të mëdha, uji që lanë, uji që rrjedhë dhe uji në enën para maces. Mos mendo se ky është tolerim; po të ishte ashtu, kjo do të ishte e njëjtë sikur gjurma që mbetet pas *istinxhës*, si edhe gjaku i mizave deri sa uji që mbërrin te këto të bëhet i papastër, e uji nuk do të përlyhet me larje, as nëse macja pi ujë në sasi të vogla.

Fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

“...nuk i pengon papastërtia”,

kërkojnë shpjegim, sepse papastërtia i pengon nëse ia ndryshon cilësitë. Nëse dikush thotë se me këto fjalë mendohet në ujin që nuk ndryshon nga papastërtia, atëherë mund të themi se kjo nënkupton që në të shumtën e rasteve, uji nuk ndryshon nga ndikimi i papastërtive të zakonshme.

I këtilli i mbahet kuptimit në rastin kur uji nuk ka arritur sasinë e dy kovave të mëdha, ndërsa ende mbetet mundësia edhe për më pak se kjo, për çka i treguam dëshmitë. Pjesa e hadithit:

"...nuk i pengon papastërtia",

nënkupton se papastërtia nuk i pengon ujit, pra – çka arrin te uji, uji i jep cilësitë e veta, siç mund të themi për shëllirën se nuk i pengon kafsha apo diçka tjetër që bie aty. Njerëzit mund të kryejnë *istinxa* me sasi të vogla të ujit, në pellg ose gropë me ujë, aty mund të fusin enë të papastra e më pas, të mbesin në dyshim se a ka ndryshuar uji cilësitë apo jo. Por do të jetë e qartë: nëse uji arrin sasinë prej dy kovave të mëdha, nuk do të ndryshojë nën ndikimin e këso papastërtive të zakonshme. Nëse thua se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

"...nuk i pengon papastërtia",

për sasinë e papastërtisë që uji e bartë, atëherë kjo është përgjegjësi e jotja, dhe ti je në kundërshti, sepse *"sasia e papastërtisë"*, nga aspekti i rregullave, vlen edhe për sasinë që mund të vërehet. Prandaj është e domosdoshme të caktohen saktë papastërtitë e zakonshme në të dy medh'hebet. Mendimi im është që papastërtisë së zakonshme duhet t'i qasemi me më shumë tolerancë, sepse kjo ka qenë edhe praktika e myslimanëve të parë, e me këtë e largojmë edhe vesvesen e shejtanit. Prandaj, në fetvanë time për çështje të njëjta, e në të cilat ekzistojnë mendime të ndryshme, i jap përparësi pastërtisë.

MËNYRAT E LARGIMIT TË PAPASTËRTISË

Nëse papastërtia nuk vërehet, mjafton të lëshohet ujë mbi gjithë sipërfaqen. E nëse vërehet, atëherë duhet të largohet, dhe përderisa ekziston edhe gjurma më e vogël e saj, kjo tregon se papastërtia nuk është larguar.

Njëjtë vlen për mbetjen e ngjyrës ose njollës, përpos pjesës që i shpërbëhet, që tolerohet pasi të jetë bërë largimi i saj dhe është pastruar mirë. Por erën duhet ta largojë. Sepse përderisa era qëndron, do të thotë nuk është pastruar, përpos kur bëhet fjalë për erë të fortë që është vështirë të largohet, e edhe ajo largohet me fërkim të fortë dhe me disa shtrydhje, siç largohet njolla me fërkim dhe me larje të mirë.

Ajo që do të largojë vesveset e shejtanit është dituria e sigurt se të gjitha gjërat (në esencë) janë krijuar të pastra, prandaj ajo në çka nuk aplikohet papastërtia, ose që me siguri dihet që në vetvete nuk ka papastërti, mund të përdoret për të larguar papastërtinë. E nuk ka nevojë të kërkojë dëshmi për ta vlerësuar sasinë e papastërtisë.

Kapitulli i dytë PASTRIMI NGA GJENDJET E PAPAstra

Pastrimi nga gjendjet e papastra (*hades*) nënkupton abdes, gusul, tejemmum, e para kësaj është istinxha. Këtu do të përmendim mënyrat se si bëhen këto, e do të përmendim edhe edebet dhe sunnetet e tyre.

RREGULLAT GJATË KRYERJES SË NEVOJËS

Ai që kryen nevojën në vend të hapur duhet të largohet nga shikimi i njerëzve dhe, sipas mundësisë, të strehohet me diçka; nuk duhet zbuluar vendin e turpshëm (*avret*) deri sa të arrijë aty ku do ta kryejë nevojën, nuk duhet kthyer kah dielli ose hëna, nuk duhet kthyer kah kibla, as me fytyrë as me shpinë, përpos kur është brenda, e edhe aty është më mirë të mos kthehet kah kibla as të mos ia kthejë shpinën.

Në vend të hapur mund të strehohet me mjetin transportues ose me një pjesë të tij. Nuk guxon të kryhet nevoja në vende ku tubohen njerëzit. Nevoja e vogël nuk guxon të bëhet në ujë që nuk rrjedhë, as nën pemë që jep fruta, as në fole a vrima të kafshëve në fushë të hapur, dhe në përgjithësi në vendet me gur, as në erë, që të mos stërpikë. Kur të ulet për të kryer nevojën, duhet mbështetur në këmbën e majtë, që ta kryej nevojën me lehtë. Në nevojtores duhet hyrë me këmbë të majtë, e të dilet nga aty me të djathtën, nuk duhet urinuar në këmbë.

Hazreti Ajsha r.anha., ka thënë:

“Mos i besoni atij që thotë se Resulallahu s.a.v.s., ka urinuar në këmbë!”

Hazreti Omeri r.a., ka treguar:

“Resulallahu s.a.v.s., më pa si urinoj në këmbë, e tha:

- Omer! Mos urino në këmbë!

Pas kësaj, kurrë nuk kam vepruar ashtu.”

Këtu ka një lehtësim: nëse për shkak të sëmundjes urinon më lehtë në këmbë, atëherë mund ta bëjë, sepse Hufejze r.a. tregon se Resulallahu s.a.v.s., një herë urinoi në këmbë, e më pas Hufejze i solli ujë për abdes, dhe Resulallahu s.a.v.s., mori abdes dhe me dorë të lagur bëri *mes’h* mbi meste.¹² Nuk duhet urinuar aty ku lahet, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Në përgjithësi, vesveset vinë nga kjo”¹³,

e Ibn Mubarek ka thënë se, *urinimi në vendin e larjes tolerohet nëse uji e çon urinën.*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Askush të mos urinojë në banjon e tij e pastaj të marrë abdes aty, sepse shumica e vesveseve janë prej kësaj”,

e Ibn Mubarek prapë ka thënë se *nëse bëhet fjalë për ujë të rrjedhshëm, atëherë nuk ka dëm.*

¹² Hadithi është *muttefekun-alejhi*.

¹³ Autorët e *Sunen-it* nga Abdullah b. Magfer.

Kur do të kryejë nevojën, me vete nuk guxon të bartë asgjë ku gjendet emri i Allahut Teala ose emri i Resulallahut s.a.v.s. Në nevojtoe nuk duhet hyrë kryeshtruar.

Para hyrjes në nevojtoe duhet thënë:

Bismilahu eudhu bilahi miner rixhsin ne xhissil habisil muhbisish shejtanir raxhim

(në emër të Allahut, tek Allahu strehohem nga çdo pisllek dhe nga sherri i shejtanit të mallkuar!),

e kur del nga nevojtoe duhet thënë:

El-hamdu lilahilezi ezhede anni ma ju'zini ve ebka alejje ma jenfeuni *(falënderim Allahut, që largoi nga unë çka më bën dëm, e mbajti çka më bën dobi).*

Para se të ulet për të kryer nevojën duhet të sigurojë gurët, nëse ka mungesë uji. Pas urinimit, ta shkundë tri herë organin, duke e mbajtur me dorë në pjesën e poshtme. Gjatë pastrimit të organit nuk duhet munduar shumë, që të mos e kaplojë vesvese e të mos i vështirësohet, e nëse ndjen lagështi, le të gjykojë se bëhet fjalë për mbetje të ujit. Nëse kjo e shqetëson, le ta përdorë përsëri ujin, që të largojë dyshimet e të pengojë vesveset e shejtanit. Tregohet se kështu vepronte Resulallahu s.a.v.s. Më të dijsmit ndër as'habët ishin ata që organin e pastronin në mënyrë të thjeshtë. Vesveset e shejtanit që lajmërohen tregojnë mungesë të asaj diturie.

Tregohet se Selmani r.a., ka thënë:

“Resulallahu s.a.v.s., na mësoi të gjitha, bile edhe si kryhet nevoja. Për pastrim pas kryerjes së nevojës na ndaloi të përdorim eshtra ose bajgë të fortë. Na ndaloi që gjatë nevojës, të vogël a të madhe, të kthehemi kah kibla”¹⁴

Një beduin i tha njërit prej as’habëve:

- *Mendoj se ti e di si bëhet nevoja dhe si pastrohet.*

- *Sigurisht që e di! Mirë bile! Shkon në një vend të fshehtë prej njerëzve, merr gurë për pastrim, kthehesh kah ndonjë bimë aromatike, shpinën ia kthen erës, e kur të ulesh poshtë, mbështetesh në pjesët e përparme të shputave, që lehtë e shpejt të kryesh nevojën.*

Lejohet që të urinohet afër tjetrit, por i strehuar me diçka. Ashtu veproi Resulallahu s.a.v.s., ani pse turpërohej shumë, por që t’ju tregojë njerëzve se kjo është e lejuar.

PASTRIMI PAS NEVOJËS SË MADHE

Pastrimi pas nevojës së madhe (*istinxa*) bëhet me tre gurë; nëse largohet papastërtia, kjo mjafton, e nëse jo, do të përdoren edhe dy gurë tjerë, sepse largimi i papastërtisë nga prapanica është i obliguar, dhe është e lavdëruar (*mustehab*) që numri i gurëve të jetë tek.

¹⁴ Shënon Muslimi, dhe tashmë është përmendur në veprën *Kavaid el-akaid*.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur dikush të pastrohet pas kryerjes së nevojës, le ta bëjë (me gurë) tek.”¹⁵

Gurin ta marrë me të majtën, ta afrojë te pjesa e përparme e anusit dhe ta fërkojë në drejtim të pjesës së pasme. Me gurin e dytë të fërkojë nga pjesa e pasme kah pjesa e përparme e anusit. Me gurin e tretë të fërkojë pjesën rreth anusit e nëse e ka vështirë, përsëri të fërkojë nga pjesa e përparme kah pjesa e pasme. Më pas, të marrë një gur më të madh në dorën e djathtë, e organin gjenital në të majtën, dhe ta fërkojë për guri, e ta përsërisë tri herë, ose të përdorë tre gurë, deri sa plotësisht të largojë gjurmët e urinës. Nëse largohen pas fërkimit të dytë, të fërkojë edhe për herë të tretë. Nëse përdorë vetëm gurë, fërkimi përsëritet tri herë, ose më shumë, por gjithmonë tek.

Në rastin kur ka ujë, le të largohet nga aty, e me ujë të pastrojë ashtu që me dorë të djathtë të derdhë ujin, e me të majtën të fërkojë deri sa me gishta të hetojë se papastërtia është larguar. Nuk do të fërkojë pjesën e brendshme të anusit sepse kjo i shkakton vesvese. Le të dihet se gjithçka që nuk e arrin uji konsiderohet e brendshme, dhe për të nuk vlejnjë rregullat e pastrimit, deri sa nuk shfaqet e të bëhet e dukshme. Ajo mund të konsiderohet e dukshme atëherë kur ta arrijë uji dhe t'a papstrojë. Kështu nuk ka vend për vesvese.

¹⁵ Hadith *muttefekun-alejhi* nga Ebu Hurejre

Pas kryerjes së nevojës, le të thotë:

***Allahumme tahhir kalbi minennifaki ve hassin
ferxhi minel-fevahish*** (O Allah! Pastroje zemrën time
nga papastërtia dhe ruaje organin tim nga shfrenimi
dhe tradhëtia).

Dorën ta fërkojë për muri ose dheu, që të largojë
erën e keqe. Është mirë të përdoret ujë pas pastrimit
me gur. Kur u shpall ajeti Kur'anor (për banorët e
Kubasë)

“... aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen mirë.”

9-Teube: 108,

Resulallahu s.a.v.s., i pyeti ata:

- ***Çfarë pastrimi është ky për të cilin ju lavdëron
Allahu Teala?***

- *Pas pastrimit me gurë, pastrohemi edhe me ujë;
i thanë.*

ABDESI

Pas pastrimit nga nevoja fiziologjike, duhet menduar për abdes.¹⁶ Kur Resulallahu s.a.v.s., e prishte abdesin, menjëherë e ripërtërinte. Abdesin duhet filluar me përdorimin e misvakut, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Vërtetë që gojët tuaja janë vend prej nga del Kur’ani. Prandaj, pastroni mirë me misvak!”¹⁷

Prandaj, kur përdoret misvaku, duhet bërë nijet pastrimin e gojës për lexim të Kur’anit dhe për dhikr.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Një namaz që falet pas përdorimit të misvakut është më i mirë se shtatëdhjetë e pesë namaze pa misvak”¹⁸

“Sikur të mos frikësohesha se do të ngarkoja ummetin tim, do t’ju urdhëroja të përdorin misvakun në secilin namaz.”¹⁹

“Pse më vini me dhëmbë të verdhë? Pastroni dhëmbët me misvak!”²⁰

¹⁶ Duhet pasë parasysh se Imam Gazali ka qenë në medh’hebin Shafi, prandaj edhe mënyra e abdesit që e shpjegon këtu ndryshon pak nga tradita jonë Hanefi (përkthyesi)

¹⁷ Ebu Nuajm në *el-Hylie*, nga Alia r.a., dhe Ibn Maxhe si hadith *mevkuf*. Të dy transmetimet janë daif.

¹⁸ Ebu Nuajm në *Kitabus-sivak*, nga Ibn Omeri.

¹⁹ Muteffekun-alejhi, nga Ebu Hurejre.

²⁰ Bezari dhe Bejhekiu nga Abbas b. Abdulmuttalib.

Resulallahu s.a.v.s., gjatë natës disa herë i pastronte dhëmbët me misvak. Abbasi r.a., ka thënë:

“Resulallahu s.a.v.s., aq shpesh na urdhëronte të pastrojmë dhëmbët me misvak, sa që mendonim se do t’i shpallet diçka në lidhje me këtë.”

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Përdorni misvakun për pastrim të dhëmbëve, sepse misvaku e pastron gojën dhe Allahu me të është razi.”²¹

Ali b. Ebu Talib k.s., ka thënë:

“Misvaku forcon memorien dhe largon këlbazin.”

As’habët e Resulallahut s.a.v.s., kur udhëtonin, misvakun e mbanin në vesh.²²

Misvaku përdoret ashtu që merret druri ‘erak’ ose lloj tjetër i drurit të fortë që mund të largojë të verdhën e dhëmbëve dhe gurëzit nga aty, dhe me atë fërkohet për së gjëri e për së gjati, ose vetëm për së gjati. Është mirë të përdoret misvaku në secilin namaz dhe në secilin abdes, qoftë edhe nëse nuk falet menjëherë pas abdesit, pas fjetjes, kur era e gojës ndryshon, ose pas ushqimit me erë të fortë.

²¹ Buhariu.

²² Shënon el-Hatibi në veprën *Kitab esma men reva an Malik*. Ebu Davudi dhe Tirmidhiu shënojnë që Zejd b. Halid mori pjesë në namaz të përbashkët, e misvakun e kishte varur në vesh, siç e mbanë shkrimtari lapsin.

Pas përdorimit të misvakut, ulet kthyer kah kibla për të marrë abdes, the thotë:

bismilahir-rahmanir-rahim,

sepse edhe Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ai që nuk fillon me bismilah, abdesi i tij nuk është i përkryer.”²³

Me këtë rast thuhet edhe kjo:

E’udhu bike min hemezatish shejtani ve e’udhu bike rabbi en jahdurun (Ty, o Rabbi im, të drejtohem për mbrojtje nga përfytyrimet e shejtanit, dhe Ty, o Rabbi im, të drejtohem që të më mbrosh nga prezenca e tyre!).

Lahen duart tri herë, dhe para se të merret ujë në gojë, thuhet:

Allahumme ibbi es-elukel-jumme vel-berekete ve e-uzu bike minesh-shu-mi vel-heleketi (O Allah! Nga Ti kërkoj sukses dhe bereqet! Nga Ti kërkoj mbrojtje nga fatkeqësia dhe syri i keq!)

Duhet të bëhet nijet (në vetvete) që abdesi të merret për largim të papastërtisë (*hades*) ose për të falë namazin. Ai nijet duhet të vazhdojë deri te larja e fytyrës. Nëse e harron nijetin paralarjes së fytyrës, atëherë abdesi nuk i vlen.

²³ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, nga Seid b. Zejd, e Tirmidhiu përcjellë nga Buhariu se ky është hadithi më i besueshëm në këtë temë.

Pas larjes së duarve, me dorën e djathtë do të marrë ujë në gojë dhe tri herë do t'a pastrojë mirë, e edhe fytyrën do ta lajë (*gargare*), e agjëruesi do ta bëjë këtë me kujdes, që uji të mos i kalojë nëpër fyt. Me këtë rast do të thotë:

Allahumme e'inni 'ala tilaveti kitabike ve kesretidh-dhikri leke (O Allah! Më ndihmo të lexoj Librin Tënd dhe të bëj Ty shumë dhikr!).

Më pas do ta marrë ujin në dorë të djathtë dhe tri herë mirë, të lajë hundën, duke tërhequr ujin në brendi të vrimave të hundës dhe duke e nxjerrë jashtë. Gjatë tërheqjes së ujit thuhet:

Allahumme evxhid li raihatel-xhenneti ve ente anni radin (O Allah! Më dhuro aromën e xhennetit, e të jesh razi me mua!),

e kur e pastron hundën, thotë:

Allahumme inni eudhu bike min revaihin-nari ve min su-id-dari (O Allah! Më mbrojt nga kutërbimi i xhehenemit dhe nga vendqëndrimi i keq!).

Pastaj të marrë ujë dhe të lajë fytyrën për së gjati, nga fillimi i flokëve deri nën mjekër, dhe nga veshi në vesh. Pjesë e fytyrës nuk llogariten pjesët e përparme e tëmthit, sepse ato janë pjesë e kokës. Uji duhet të arrijë deri tek pjesa ku gratë zakonisht i bëjnë bistekët. Gjithashtu, uji duhet të arrijë rrënjët e flokut, vetullat, mustaqet, zylyfet e qerpikët, sepse në këto vende floku është më i dobët e më i rrallë.

Uji duhet të arrijë edhe deri te rrënjët e mjekrës së rrallë, e nuk duhet domosdo të arrijë rrënjët e mjekrës së dendur e të gjatë, e kjo vlen edhe për pjesën e mjekrës nën buzë. Larja e fytyrës në këtë mënyrë përsëritet tri herë, ose nëse mjekra është e dendur dhe e gjatë, vetëm kalohet uji nëpër të. Me gishta duhet fërkuar edhe gropat e syve, përfshirë sklepat, si edhe vendin ku vendoset surmeja, dhe ato duhet pastruar mirë. Transmetohet se *Resulallahu s.a.v.s., kështu ka vepruar*. Gjatë kësaj, mbanë ymyt për largimin e gjynahut nga sytë e tij, e njëjtë edhe për pjesët tjera të trupit. E gjatë larjes së fytyrës, bën këtë dua:

Allahume bejjid vexhhi bi nurike jevme tebjeddu vuxhuhu evlija-ike ve la tusevvid vexhhi bi zulumatike jevme tesveddu vuxhuhu ada-ike (O Allah, ndriçoje fytyrën time në ditën e Gjykimit, kur fytyrat e miqve Tu do të ndriçojnë, e mos e nxijë fytyrën time në ditën kur fytyrat e armiqve Tu do të jenë të nxira).

Tërhiqja e gishtave nëpër mjekrën e gjatë e të dendur gjatë larjes së fytyrës është e lavdërueshme (*mustehab*).

Me qëllim që të shtojë nurin, i lanë duart deri përmbi bërryla, sepse *në ditën e gjykimit njerëzit do të ngjallen dhe do të njihen me nishanin ndriçues nga gjurmët e abdesit*. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush është në gjendje që të shtojë nurin e vet, le ta bëjë.”²⁴

²⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre

Tregohet se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Vërtetë që zbukurimi në Ditën e gjykimit arrin deri aty ku ka arrit pastrimi gjatë marrjes së abdesit.”²⁵

Pastrimi i duarve do të fillojë me larjen e dorës së djathtë, me duanë:

Allahumme atini kitabi bi jemini ve hasibni hisaben jesira (O Allah, më jep librin e veprave të mia nga ana e djathtë dhe ma lehtëso llogarinë!),

e gjatë larjes së dorës së majtë, do të bëj dua:

Allahumme inni eudhu bike en tutijeni kitabi bi shimali ev min vera-i zahri (O Allah! Tek ti strehohem të mos më japësh librin e veprave të mia nga e majta, e as pas shpinës time!)

Pastaj ta fërkojë kokën, duke lagur majat e gishtave të dy duarve bashkuare t'i vendosë mbi ballë e t'i tërheqë mbrapa deri pas kokës, dhe t'i kthejë në fillim. Një këso veprimi është një fërkim, e këtë do ta përsërisë tri herë, duke bërë duanë:

Allahumme gashshini bi rahmetike ve endhil alejje min berekatike ve edhilleni tahte dhilli arshike jevme la dhille illa dhilluke (O Allah, mbuloje kokën time me rahmetin Tënd, më dhuro mirësitë e Tua dhe më vendos në flladin e Arshit Tënd në ditën kur fllad tjetër përpos flladit Tënd, nuk do të ketë!).

²⁵Buhariu dhe Muslimi

Do t'i lagë duart prapë e të pastrojë pjesën e jashtme dhe të brendshme të veshit, ashtu që gishtin tregues do ta vendosë në pjesën e brendshme të veshit, e me gishtin e madh do të fërkojë pjesën e jashtme, dhe në fund, vendosë shuplakën mbi vesh. Këtë do ta përsërisë tri herë, duke bërë dua:

Allahumme-xh'alni minel-ledhine jestemiunel-kavle fe jettebiune ahseneh. Allahumme esmini munadijel-xhenneti meal-ebrrar (O Allah, më bëj nga ata që dëgjojnë fjalët Tua, dhe i pasojnë ato! O Allah! Ma mundëso, që në shoqëri me të mirët, të dëgjoj thirrjen e atij që thërret në xhennet!).

Përsëri do t'i lagë duart dhe do ta fërkojë qafën, sepse Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Fërkimi i qafës është mbrojtje nga prangat e zjarrit në Ditën e gjykimit.”²⁶

Gjatë fërkimit të qafës thuhet kjo dua:

Allahumme fukke rekaveti minen-nari ve eudhu bike minesh-selasili vel-aglal (O Allah! Më mbrojt nga zjarri i xhehenemit, e qafën time ma mbrojt nga prangat e zjarrit!).

Pastaj do të lajë këmbët tri herë, dhe fillon me larjen e këmbës së djathtë. Me gishtat e dorës së majtë do të lajë dhe do të fërkojë pjesët mes gishtave të këmbës së djathtë, nisur nga gishti i vogël i këmbës së djathtë, dhe përfundon me gishtin e njëjtë të këmbës së majtë.

²⁶ Shënon Ebu Mensur Dejlemi në veprën *Musnedul-Firdevs*, nga Omeri r.a, si hadith *daif*

Gjatë larjes së këmbës së djathtë bën këtë dua:

Allahumme sebbit kademejje ales-siratil-mustekim jevme tedhillul-akdamu fin-nar (O Allahu im, forcoi këmbët e mia në urën e siratit, në ditën kur rrëshqasin këmbët në zjarr!),

e gjatë larjes së këmbës së majtë do të bëj dua:

E'udhu bike en tedhille kademejje anis-sirati jevme tezillu fihi akdamul-munafikine (tek Ti strehohem që këmbët të mos më rrëshqasin në urën sirat në ditën kur rrëshqasin këmbët e dyfytërëshit!)

Këmbët duhet larë deri mbi nyje. Pas përfundimit të larjes, të ngris kokën e të thotë:

Eshhedu en la ilahe ilallahu vahdedu la sherike leh, ve eshedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu. Subhanekallahumme ve bi hamdike la ilahe ila ente amiltu su-en ve zalemte nefsi estagfirukallahumme ve etebu ilejke fag-fir li ve tub alejje inneke entet-tevvabur-rahim. Allahumme-xh'alni minet-tevvabine ve-xh'alni minel-mutetah-hirine, ve-xh'alni min ibadikes-salihine ve xh'alni abden saburen shekuren ve-xh'alni edhkuruke kesiren ve usebbihuke bukreten ve esila (Dëshmoj se nuk ka ilah tjetër pos Allahut, Një dhe i Vetmi, i Cili nuk ka të ngjashëm. Gjithashtu, dëshmoj që Muhammedi (s.a.v.s.) është rob dhe i dërguar i Tij. I Lavdëruar e i Madhëruar Ti je, o Allah! Nuk ka zot tjetër pos Teje! Kam bërë vepra të këqija dhe i kam bërë vetes padrejtësi, dhe tash nga Ti kërkoj falje dhe Ty të lus për mëshirë, prandaj më fal dhe më mëshiro, sepse Ti falë shumë dhe je i mëshirshëm!

O Allah! Më bëj nga ata që kërkojnë shumë faljen tënde dhe nga ata që pastrohen! Bëj që të jem nga robët e Tu të singertë! Më bëj rob Tëndin të durueshëm e falënderues! Më mundëso të të përmend shumë Ty, në mëngjes e në mbrëmje, të jam falënderues!)

Transmetohet se ai që e bën këtë dua pas marrjes së abdesit, abdesi do t'i vuloset, i ngritur nën Arsh, do të lavdërojë e madhërojë Allahun Teala e do t'i shkruhen sevape, deri në Ditën e gjykimit.

TË PAPËLQYERA (MEKRUH) TË ABDESIT

Nuk është mirë të lahen pjesët e trupit më shumë se tri herë. Ai që kështu vepron, e ka tepruar sepse nuk është mirë të harxhohet shumë ujë kur merret abdes. Resulallahu s.a.v.s., mori abdes duke larë pjesët e trupit tri herë, e më pas tha:

“Kush shton diçka në këtë, ka bërë zullum dhe e ka tepruar.”²⁷

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Pas meje, në ummetin tim, do të ketë njerëz që do të kalojnë kufijtë në dua dhe pastrim.”²⁸

Është thënë: *një nga shenjat e dobësisë së diturisë së njeriut është përdorimi i tepruar iujit gjatë pastrimit.*

²⁷ Ebu Davud dhe Nesai, ndërsa Ibn Maxhe nga Amr b. Shuajb

²⁸ Ebu Davud, Ibn Maxhe, Ibn Hibban dhe Hakimi nga Abdullah b. Mugaffel.

Ibrahim b. Ed'hem thotë:
“*Vesvese fillimisht nisë te pastrimi.*”

Hasan Basriu ka thënë:
“*Shejtani i quajtur Velhan u jep vesvese njerëzve në abdes.*”

Është e shëmtuar të shkundet uji nga dora, të flitet gjatë marrjes së abdesit dhe që me ujë të spërkatet fytyra. Disa thonë që nuk është mirë të fshijmë ujin pas abdesit. Ata thonë se *uji i abdesit do të vendoset në peshore*. E këta janë Said b. Musejjib dhe Dhuhri. Por Muadh bin Xhebel r.a., ka thënë se *Resulallahu s.a.v.s., e fshinte fytyrën me fundin e mantelit të vet.*²⁹ Edhe nga Ajshe r.anha është transmetuar se *Resulallahu s.a.v.s., e kishte peshqirin e vet.*³⁰ Megjithatë, ka dyshime për këtë transmetim nga Ajshe r. anha.

Nuk është mirë të merret abdes nga ena e bronzit e as me ujin që është ngrohur në Diell, për arsye shëndetësore. Tregohet nga Ibn Omeri r.a., dhe Ebu Hurejre r.a., që nuk është mirë të përdoren enët e bronzit. Dikush ka treguar:

“*I solla Shu'biut ujë në enë bronzi, e ai refuzoi të marrë abdes me ujin nga ajo enë.*”

²⁹ Shënon Tirmidhiu dhe thotë që është hadith *garib*, dhe zinxhiri i transmetuesve është i dobët.

³⁰ Shënon Tirmidhiu dhe thotë që për këtë temë nuk ka transmetime të besueshme nga Resulallahu s.a.v.s..

Pas përfundimit të marrjes abdes dhe përgatitjes për faljen e namazit, myslimani duhet të mendojë që i ka pastruar pjesët e jashtme të trupit, që u ekspozohen shikimeve të krijesave. Për këtë, ai do të duhej të turpërohej para Allahut Teala, sepse Atij po i drejtohet me zemër të papastër, e cila i është ekspozuar shikimit të Rabbit të vet.

Prandaj do të duhej që, para së gjithash, të kontrollojë se a i është pastruar zemra me pendim, a janë larguar nga ai sjelljet e shëmtuara dhe a i është mbushur zemra me cilësi të mira e të lavdërueshme. Do të duhej ta dijë se ai që e pastron vetëm të jashtmen e vet përngjanë në atë që do të donte ta thërrasë mbretin në shtëpi të vet, dhe e rregullon e zbukuron derën e shtëpisë, por brendësinë e saj e lë të mbushur me ndyrësi. Secili do ta qortonte një të këtillë, e Allahu Teala e di më së miri.

FAZILETI (VLERA E LARTË) E ABDESIT

Hadithet në këtë çështje:

“Kush merr abdes si duhet dhe i falë dy reqate namaz duke mos menduar për dynjallëk, do të jetë i pastër nga gjynahet sikur atë ditë kur e ka lindur nëna.”³¹

³¹ Ibn Mubarek në veprën *Kitab ez-zuhdi ver-reka-iki, si muttefekun-alejhi* nga Osman b. Affan, por pa fjalët:
duke mos menduar për dynjallëk.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“A t’ju tregoj me çka Allahu Teala i largon gjynahet dhe i ngritë gradat? Me marrje të abdesit në mënyrën më të mirë dhe me të gjitha rregullat, përkundër vështirësive, me hyrje në xhami dhe me pritje të namazit pas namazit. Ky është qëndrimi në rrugë të Allahut! Ky është qëndrimi në rrugë të Allahut! Ky është qëndrimi në rrugë të Allahut!”³²

Resulallahu s.a.v.s., mori abdes duke i larë pjesët e trupit nga një herë, dhe tha:

- Ky është abdesi për të cilin Allahu Teala do të shpërblejë një herë;

pastaj Resulallahu s.a.v.s., mori abdes duke i larë pjesët e trupit nga dy herë, e tha:

- Kush i lanë pjesët e trupit nga dy herë kur merr abdes, Allahu Teala do t’i japë shpërblim të dyfishtë;

pastaj mori abdes duke i larë pjesët e trupit nga tri herë, dhe atëherë tha:

- Ky është abdesi im dhe i pejgamberëve para meje, e ky është edhe abdesi i Halilurrahman (mikut të Allahut), Ibrahimit a.s.³³

Shënon edhe Ebu Davudi nga Zejd b. Halid në formën:

Më pas falë namazin pa u humbur në mendime.

³²Muslimi nga Ebu Hurejre

³³Ibn Maxhe nga Ibn Omeri.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush e përmend Allahun Teala kur merr abdes, Allahu Teala ia pastron gjithë trupin. E kush gjatë abdesit nuk e përmend emrin e Allahut, atij do t’i pastrohen vetëm pjesët e trupit që i ka arrit uji.”³⁴, dhe ka thënë:

“Kush merr abdes mbi abdes, Allahu Teala do t’ia shkruajë atij dhjetë sevape.”³⁵

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Abdesi mbi abdes është si dritë e re mbi dritë.”³⁶

E gjithë kjo është nxitje për ripërtëritje të vazhdueshme të abdesit.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur muslimani duke marrë abdes e shpërlanë gojën, atij i dalin gabimet nga goja e tij; kur e shpërlanë hundën, i dalin gabimet nga hunda e tij; kur e lanë fytyrën, i largohen gabimet nga fytyra, bile edhe nga kapakëte syve të tij; kur i lanë duart, i largohen gabimet nga duart deri sa të largohen edhe prej pjesës nën thonjtë e tij; kur e lagë kokën, i dalin gabimet nga koka, bile dalin edhe prej pjesës nën veshët e tij; kur i lanë këmbët, i largohen gabimet nga këmbët, edhe prej pjesës nën thonjtë e këmbëve të tij; e më pas, hyrja e tij në xhami dhe namazi i tij do t’i jenë shtesë (do të ketë shpërblim të veçantë për to).”³⁷

³⁴ Darekutni nga Ebu Hurejre.

³⁵ Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Ibn Omeri.

³⁶ Nuk është gjetur në burime.

³⁷ Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe nga es-Sunabihui me zinxhir të besueshëm të transmetuesve, por rreth tekstit të tij ka mendime të

Gjithashtu, tregohet se *muslimani me abdes është si agjëruesi*.³⁸

E Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Kush merr abdes në mënyrën më të bukur dhe sipas rregullave, e më pas drejton shikimin kah qielli e bën dua: ‘Eshehedu en la ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh, ve eshedu enne Muhammeden abduhu veresuluhu’, do të hapen për të tetë dyer të xhennetit, dhe ai mund të hyjë nga cila derë të dëshirojë.”³⁹

Omeri r.a. ka thënë:

“Abdesi i drejtë dhe i plotë e largon shejtanin prej teje.”

E Muxhahidi ka thënë:

“Kush është në gjendje të shtrihet në shtrat me abdes, duke bërë dhikër e duke kërkuar falje prej Allahut Teala, ashtu edhe le të veprojë, sepse shpirtërat do të ngjallen në atë gjendje në të cilën e kanë lëshuar këtë botë.”

ndryshme. Shënon edhe Muslimi në formë më të shkurtë nga Ebu Hurejre dhe Amr b. Anbes.

³⁸ Ebu Mansur Dejemi nga Amr b. Harisi, me zinxhir të dobët

³⁹ Ebu Davudi nga Ukbe b. Amir. Te Muslimi mungojnë fjalët:

e më pas drejton shikimin kah qielli.

Në këtë formë është i shkruar edhe në veprën *el-Atraf*, si dhe në *el-Jevm vel-lejle* nga Ukbe b. Amir. Në këtë formë e shënon edhe Darimi në veprën e tij *Musned*.

MËNYRA E BËRJES GUSUL (LARJES)

Fillimisht, ena me ujë vendoset në anën e djathtë, e më pas thuhet *bismilah*. Pastaj lahen duart tri herë, bëhet *istinxha*, ashtu siç e përshkruam më herët, largohet papastërtia eventuale nga i gjithë trupi, e më pas merret abdes, siç merret për namaz, dhe ashtu siç e kemi shpjeguar më parë, me atë që larja e këmbëve lihet për fund të larjes, sepse po të laheshin në fillim, e më pas prapë lëshohen në tokë, do të duhej të lahen përsëri, e kjo do të ishte harxhim i tepruar i ujit. Pas kësaj, uji derdhet në kokë, tri herë, më pas në anën e djathtë të trupit, më pas në të majtën, gjithmonë nga tri herë. Më pas, fërkohet dhe lahet pjesa e përparme, e më pas pjesa e pasme e trupit, me gishta fërkohen flokët dhe mjekra, ashtu që uji të arrijë deri te rrënja e flokut, pa marrë parasysh dendësinë e tij. Gruaja nuk ka nevojë t'i prishë bishtalecat, përpos nëse është e sigurt që ashtu uji nuk do t'i arrijë te rrënjët. Qafën dhe bërrylat duhet larë mirë. Duhet pasur kujdes të mos preket organi gjenital gjatë larjes. Nëse kjo ndodhë, atëherë duhet ripërtërirë abdesin. Nëse merret abdes para larjes, atëherë nuk duhet përsëritur pas larjes.

Këto janë sunnetet e abdesit dhe gusulit. E përmendëm vetëm atë që është e domosdoshme për atë që ndjekë rrugën e ahiretit, e për gjëra tjera dhe çështje në të cilat mund të hasë në jetë, le të kërkojë përgjigje në veprat e fikhut.

Ka dy gjëra farz (të obligueshme) te gusuli: nijeti dhe larja e të gjithë trupit me ujë, e farze të abdesit janë nijeti, larja e fytyrës, larja e duarve deri përmbi bërryla, lagia e kokës, larja e këmbëve deri mbi nyje, si edhe renditja në pastrim, e vazhdueshmëria gjatë larjes nuk është e obliguar.

Gusuli është i obligueshëm (*farz*) në katër raste:

1. pas derdhjes së spermës nga organi gjeneral me epsh, qoftë kur jemi të zgjuar apo në gjumë.
2. pas bashkimit të dy organeve gjentiale, edhe në qoftë se nuk ejakulon
3. pas pastrimit mujor, (*hajz*)
4. në përfundim të periudhës së pas-lindjes (*nifas*).

Larja është sunnet për bajram, xhuma, festa, me rastin e veshjes së ihramit, me rastin e qëndrimit në Arafat dhe Muzdelife, para hyrjes në Mekë, larje në tri ditët e Kurban bajramit (11, 12, 13 *dhulhixhxe*), për ta bërë tavafin lamtumirës, sipas një mendimi – edhe kur jobesimtari e pranon islamin, përpos nëse nuk ka qenë xhunup, kur i luajturi mendsh të vijë në vete, ai që e lanë të vdekurin. Larjet në këto situata janë të lavdërueshme.

MËNYRA E TEJEMMUMIT

Nëse nuk mund të sigurojë ujë edhe pas kërkimit, ose nuk mund ta arrijë për shkak të ndonjë bishe a pengese, ose i duhet atij apo bashkëudhëtarit të tij për pije, ose nuk mund ta blejë për shkak të çmimit të lartë, ose ka plagë a sëmundje që mund të keqësohet në kontakt me ujin - duhet të presë kohën e namazit dhe me shuplakë e gishtërinj të bashkuar të prekë dheun e terur e të pastër dhe të fërkojë fytyrën një herë, me nijet që të falë namazin. Nuk është obligim që dheu të arrijë nën qime të mjekrës, e pa marrë parasysh sa e shpeshtë është ajo, do të tentojë që dheu të arrijë lëkurën e fytyrës, e kjo arrihet me një fërkim, sepse gjerësia e fytyrës nuk e kalon gjerësinë e dy shuplakave. Mjafton nëse te ai që bën tejemmum dominon mendimi se me fërkim e ka përfshirë të gjithë fytyrën. Pas kësaj, të prekë për herë të dytë në dhé, pasi të ketë hequr unazën, duke i hapur gishtërinjtë, dhe me dorën e majtë ta fërkojë të djathtën deri mbi bërryl, e me të djathtën e fërkon të majtën deri mbi bërryl, nga një herë. Qëllimi i kësaj është që me një prekje të dheut të fërkohen duart deri në bërryl. Megjithatë, nëse me një goditje nuk merr aq dhé sa për të fërkuar të dy duart, do të godasë dhéun prapë.

Pasi që me tejemmum të falë namazin farz, më pas mund të falë namaze nafile. Por nëse dëshiron të falë edhe një farz tjetër, do t'i duhet të bëj prapë tejemmum. Pra, për secilin namaz farz duhet të marrë tejemmum të ri, e Allahu Teala e di më së miri.

Kapitulli i tretë
PAPASTËRTIA E PJESËVE TË TRUPIT

PAPASTËRTIA DHE LAGËSHTIA E NGJITUR

1. *Papastërtia që mblidhet në flokë.*

Do të ishte mirë (*mustehab*) të pastrohen flokët me ujë, të krehen e të lyhen me vaj, që të largohet parregullsia. Resulallahu s.a.v.s., *lyente flokët me vaj, nganjëherë i krihte dhe të njëjtën ju urdhëronte të tjerëve.*⁴⁰

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kohë pas kohe lyeni dhe pastroni flokët.”⁴¹

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush i rrit flokët, le të kujdeset mirë për to.”⁴²

⁴⁰ Është shënuar në *esh-Shemail*, nga Enesi, me zinxhir të dobët të transmetuesve:

Shpesh i lyente flokët me vaj, dhe e krihte mjekrën.

Gjithashtu, në *esh-Shemail* shënohet hadith me zinxhir të besueshëm të transmetuesve, nga një as'hab që nuk i përmendet emri, e ku thuhet se Resulallahu s.a.v.s., nganjëherë i krihte flokët ⁴¹ Ibn Salah thotë që nuk e ka gjetur në burime. En-Nevevi ka thënë se është hadith i panjohur (*gajr ma'ruf*). Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesai shënojnë nga Abdullah b. Mugaffel, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve, e ku thuhet që *Resulallahu s.a.v.s., e ka ndaluar krehjen, përpos kohë pas kohe.*

⁴² Shënohet nga Ebu Hurejre, por zinxhiri i transmetuesve nuk është edhe aq i besueshëm.

Një person hyri te Resulallahu s.a.v.s., me flokë të përhapura e mjekër të çrregullt, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- ***A nuk kishte vaj ky që t'i palojë e drejtojë pak flokët e tij?***, e më pas shtoi:

- ***Disa prej jush vijnë si kafshë e egër!***⁴³

2. Papastërtia që mblidhet në veshë.

Kjo papastërti e dukshme mund të pastrohet me fërkim, ndërsa papastërtia që mblidhet në thellësinë e kanalit të veshit, largohet butësisht gjatë larjes. Sepse, nëse mblidhet më shumë papastërti aty, mund të dëmtojë dëgjimin.

3. Papastërtia brenda hundës dhe qyrrat.

Këto pastrohen me shpërlarje të hundës dhe fryrje.

4. Papastërtia dhe verdhësia në dhëmbë e gjuhë.

Kjo pastrohet me përdorimin e misvakut dhe me shpërlarjen e gojës.

5. Papastërtia dhe morrat në mjekër.

Atë papastërti është mirë ta largojë me përdorimin e ujit dhe me krehër. Është shënuar që Resulallahu s.a.v.s., *gjithmonë me vete bartte krehër dhe pasqyrë, edhe kur udhëtonte edhe kur nuk udhëtonte.*⁴⁴

⁴³ Shënojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Hibban nga Xhabiri.

⁴⁴ Shënon Ibn Tahir në *Shifatut-tesavvuf*, nga Ebu Seid:

“Misvaku dhe krehëri i tij gjithmonë ishin në vendin ku falej.”

Shënon edhe Taberani në *El-Evsat* nga Ajsha r.anha., e zinxhiri i

Ky është adet i arabëve. Në një transmetim *garib* thuhet se *Resulallahu s.a.v.s., e krihte mjekrën dy herë në ditë*⁴⁵ dhe që, *Resulallahu s.a.v.s., kishte mjekër të dendur*.⁴⁶ Mjekër të njëjtë kishte edhe Ebu Bekr. Osmani kishte mjekër të gjatë e të rrallë, ndërsa Alia kishte mjekër të dendur e të gjerë, ashtu që ia mbushte hapësirën nga një krah te tjetri. Në një hadith *garib* thuhet se Ajsha r.anha ka thënë:

“Para dyerve të Resulallahut s.a.v.s., u mblodhën njerëzit. Doli, e unë shikoja se si me kujdes rregullon flokët dhe mjekrën. I thashë:

- O Resulallah, a edhe ti po zbukurohesh?, e më tha:

*- Po. Vërtetë Allahu Teala e do robin e tij që zbukurohet kur del para vëllezërve të tij.”*⁴⁷

Vetëm i padijshmi mund të mendojë se si kjo ka qenë nga dëshira për zbukurim para njerëzve. Resulallahu s.a.v.s., e kishte obligim t’i thërras njerëzit në fe. Prandaj detyrë e tij ishte të kujdeset për vete dhe pozitën e tij te njerëzit, që të mos e nënçmojnë e refuzojnë.

transmetuesve i të dy transmetimeve nuk është i besueshëm. Në formë më të gjatë do ta sjellim në veprën *Adab el-sefer*.

⁴⁵ Tashmë e kemi përmendur, ndërsa në transmetim nga Enesi thuhet:

“Resulallahu s.a.v.s. shpesh e krihte mjekrën.”

E shënon Hatibi në veprën *el-Xhami* nga Hakemi si *mursel*:

“Resulallahu s.a.v.s., e krihte mjekrën me krehër”.

⁴⁶ Shënon Tirmidhiu në *esh-Shemail*, nga Hind b. Ebu Hale, Ebu Nuajm në *Delail en-nubuvve*, nga Alia r.a. Burimisht është shënuar te Tirmidhiu.

⁴⁷ Shënon Ibn Adijj duke e theksuar se është hadith *munker*.

Obligim i tij ka qenë që në sytë e tyre të lë ndikim të fuqishëm, që të mos largohen nga ai. Por munafikët kërkojnë çfarëdo arsyeje që ta përçmojnë Resulallahun s.a.v.s., në sytë e njerëzve. Prandaj secili dijetar (*alim*) që thërret njerëzit në fe, është i obliguar të kujdeset për pamjen e vet të jashtme dhe në atë që do të mund t'i largonte njerëzit nga ai.

Këtu ka rëndësi qëllimi dhe ai merret edhe si kufi. Zbukurimi me këtë qëllim është veprim i mirë dhe i dëshirueshëm, ndërsa moskujdesi për mjekër që me këtë të tregojë mbështetjen te Allahu Teala (*zuhd*), është ajo prej sëcilës duhet ruajtur mirë. Por braktisja e kujdesit për mjekër me nijet që të merret me një vepër më të rëndësishme është veprim i mirë dhe i lavdëruar. Ky nijet është një gjendje e fshehtë që mbetet vetëm mes robit dhe Allahut. Ai që i kushton vëmendje kësaj është i kujdesshëm dhe beson që Allahu Teala e di hakikatin. Sa e sa ka të padijshëm, që me zbukurim tentojnë të tërheqin vëmendjen e njerëzve! Të atillët mashtrojnë veten, e edhe të tjerët, duke pohuar se me këtë e synojnë të mirën. Ka edhe dijetarë që veshin rroba të shtrenjta duke pohuar se kështu dëshirojnë të nënçmojnë bidatxhijtë dhe kundërshtarët, dhe t'i afrohen Allahut Teala. Kjo do të bëhet e qartë në

'ditën, kur do të zbulohen të fshehtat' (86-Tarik: 9),

kur të ngjallet krejt çka ka në varreza, kur të del në pah ajo që ishte në zemra, atëherë do të kuptohet qëllimi i singertë e i pastër. Allahu Teala na ruajt prej poshtërsisë në Ditën e ringjalljes!

6. *Largimi i papastërtisë nga nyjet e gishtave.*

Arabët nuk e kishin shumë adet të pastrojnë këto pjesë sepse nuk i lanin duart pas ushqimit, e papastërtia tubohej. Prandaj *Resulallahu s.a.v.s., ju urdhëroi t'i lajnë nyjet.*⁴⁸

7. *Mirëmbajtja dhe pastrimi i thonjve.*

Resulallahu s.a.v.s., urdhëroi t'i pastrojnë për shkak që Arabët nuk kishin gjithmonë gërshërë. Për këtë arsye, në këto pjesë krijohen shtresa të papastërtisë. Prandaj *Resulallahu s.a.v.s., ju urdhëroi⁴⁹ myslimanëve prerjen e thonjve, heqjen e qimeve nën sqetulla, rruajtjen e vendeve të turpshme në periudhë prej katërdhjetë ditëve.*⁵⁰

E Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu *ka urdhëruar largimin e papastërtisë nën thonj.*⁵¹

⁴⁸ Tirmidhiu në *en-Nevadirnga* Abdullah b. Bisr:

“Pastroni nyjet tuaja!”

Ibn Adijj nga Enesi:

“Kujdes pastërtinë e nyjeve tuaja kur merrni abdes!”

Muslimi nga Ajshe r.anha:

“Dhjetë gjëra i janë natyrale njeriut:...”, ku mes tjerash përmend edhe larjen e nyjeve.

⁴⁹ Ahmedi nga Ibn Abbasi: *“I thanë Resulallahut s.a.v.s.:*

- Gjatë nuk të erdhi Xhebraili a.s.; e ai ju tha:

- Nuk është çudi që nuk erdhi, kur ju nuk më pasoni mua: nuk i preni thonjtë, nuk i shkurtoni mustaqet dhe nuk e largoni papastërtinë nën thonj.”

Në zinxhirin e transmetuesve gjendet edhe Ismail b. Ajjash.

⁵⁰ Shënon Muslimi nga Enesi.

⁵¹ Taberani nga Vabis b. Seid, që thotë: *“E pyeta Resulallahun s.a.v.s., për gjithçka, bile edhe për papastërtinë nën thonj, e më tha:*

Në një transmetim thuhet se Resulallahut s.a.v.s., një kohë të gjatë nuk i erdh shpallje, e kur i erdhi Xhebraili a.s., i tha:

- Si t'ju vijmë kur nuk i lani bërrylat, nuk e largoni papastërtinë nën thonjët tuaj dhe nuk e përdorni misvakun për të larguar verdhësinë nga dhëmbët tuaj? Urdhëroja këtë ummetit tënd!⁵²

Allahu Teala thotë:

“...mos u thuaj as *uh!*” (17-Isra: 23),

e një kuptim i këtij ajeti është:

mos ju merr për të madhe papastërtinë nën thonj.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka urdhëruar të largohet edhe papastërtia nga veshi.

8. Papastërtia në trup nga djersa e pluhuri.

Kjo papastërti largohet me larje. Myslimani nuk e ka të ndaluar hyrjen në hamam. Është shënuar që as'habët hynin në hamame në Sham. Njëri nga ta ka thënë:

“Sa të bukura që janë këto hamame; e pastrojnë trupin dhe ia kujtojnë njeriut Zjarrin.”

Kjo tregohet nga Ebu Derda dhe Ebu Ejjub el-Ensari r.a.. Megjithatë, është shënuar që disa kanë thënë:

“Sa të shëmtuara që janë këto hamame; e zbulojnë avret-in (pjesët e turpshme) dhe e largojnë turpin.”

“Largoje atë që në ty shkakton dyshim dhe merru me atë ku nuk ka dyshim.”

⁵² Tashmë e kemi përmendur.

Këto janë anët e shëmtuara të hamamit, e ato ishin të mirat. Anët e mira mund të përdoren, me atë që të ketë kujdes nga ajo që nuk është e mirë.

Sido që të jetë, ai që hyn në hamam duhet t'i përmbahet obligimeve (*vaxhib*) dhe sunnetit. Ka dy obligime në lidhje me pjesët e veta të turpshme (*avret*), dhe dy obligime në lidhje me pjesët e turpshme të tjetër kujt.

Avret-in e tij është i obliguar ta ruajë nga shikimi dhe prekja e të tjerëve. Vetëm me dorën e vet guxon të largojë papastërtinë. I ndalohet masazherit të hamamit pjesa prej kërthizës deri nën gju. Këto pjesë duhet t'i pastrojë vet. Pjesët tjera mund t'i fërkojë.

Sa për pjesët e turpshme të tjetrit, është i obliguar të ulë shikimin, pra të mos shikojë në *avret* të tjetrit dhe ta ndalojë tjetrin të zbulohet, sepse ndalimi i gjithë asaj që nuk është e mirë, është obligim.

Prandaj myslimani duhet t'ia tërheqë vërejtjen e nga tjetri varet a do ta pranojë këtë apo jo. Përpos nëse ka frikë se mund të sulmohet, fizikisht ose me fjalë, ose nëse ai tjetri, për shkak të asaj vërejtjeje, të bëjë ndonjë haram tjetër, vetëm në atë rast mund ta heshtë. Por, nëse i thotë vetes: *"E di që nuk do të ketë efekt, ai nuk do të dëgjojë"*,

ky nuk është kurrfarë arsytimi që të mos këshillojë.

Ai duhet ta këshillojë sepse fjalët kanë ndikim mbi zemrat dhe është e mundur që gjatë tërheqjes së vërejtjes tjetri ta kuptojë gabimin e mos të gabojë. Prandaj këshilla nuk duhet të braktiset.

Për shkak të këso gjërave, sot është më mirë të mos shkohet në hamam, sepse në këtë kohë (koha e Gazalit) vështirë se kalon pa zbulimin e *avret*-it, posaqërisht prej kërthizës deri te pjesa e turpshme. Shumica as nuk e konsiderojnë këtë pjesë avret, e sipas sheriatit, ajo pjesë është *avret* dhe rreptësisht e ndaluar të shikohet. Prandaj më së miri do të ishte të zbraset hamami. Bishr b. el-Haris ka thënë:

“Sa i kujdesshëm është ai që paguan edhe dërhemin e fundit vetëm që ta zbrasë hamamin për vete.”

Ibn Omeri r.a. u pa në hamam me fytyrë të kthyer kah muri e me peshqir lidhur mbi sy, ndërsa dikush pat thënë:

“Lejohet hyrja në hamam, por vetëm me dy peshqirë; me njërin të mbulojë avretin e me tjetrin kokën, që t’i ruajë sytë nga shikimet e ndaluara.”

SUNNETET GJATË QËNDRIMIT NË HAMAME

1. Nijeti i drejtë. Në hamam nuk duhet hyrë për dobi të kësaj bote, as për kënaqjen e kërkesave të veta. Në hamam duhet hyrë me nijetin që të pastrohet mirë dhe që më së miri të përgatitet për namaz.

2. Pagesa bëhet para hyrjes, sepse nuk dihet çfarë ka brenda, e as pritjet e pronarit nuk dihen. Prandaj me pagesë para hyrjes largohet e panjohura dhe e kënaq edhe pronarin e hamamit.

3. Hyrja bëhet me këmbë të majtë, me duanë:
bismilahir-rahmanir-rahim, e'udhu bilahi miner rixhsin nexhisil habisil muhbisish shejtanir-raxhim (Me Emër të Allahut, Mëshirues e Mëshirëplotë! Tek Allahu strehohem nga papastërtia dhe ndyrësia, nga ajo që bën dëm dhe që sjellë dëm, dhe nga shejtani i mallkuar!)

4. Në hamam shkohet në kohën kur nuk ka vizitorë tjerë, ose paguhet për të gjithë hamamin, sepse edhe nëse në hamam janë besimtarët dhe ata që e ruajnë avret-in, vet shikimi i trupave të zhveshur tregon mungesën e turpfit, e kjo do të mund ta nxiste të shikojë në avret. Personi duhet gjithmonë të ketë kujdes që me lëvizjet e tij të mos zbulojë avretin, qoftë edhe pa qëllim.

5. Kur të hyjë, duhet lagur trupin nga të dy anët dhe të mos hyjë në pjesën e nxehtë para se trupi të djersitet e të ngrohet.

6. Ujin nuk duhet harxhuar kot, por vetëm aq sa është e nevojshme. Lejohet sasia e zakonshme, e teprim është gjithë ajo sasi që, po ta dinte pronari, nuk do të ishte i lumtur. Kjo posaçërisht ka të bëjë me përdorimin e ujit të nxehtë, sepse në të edhe investohet më shumë.

7. Temperatura e ujit dhe e hamamit duhet t'ia kujtojë të nxehtit e xhehenemit. Le të mendohet i mbyllur e i kërrusur në pjesën më të nxehtë të hamamit për vetëm një orë, dhe le ta krahasojë atë gjendje me xhehenemin. Ajo pjesë e nxehtë e hamamit më së shumti të kujton xhehenemin: zjarri dhe nxehtësia që vijnë nga poshtë, ndërsa lartë - terr! Allahu na ruajtë! Njeriu i arsyeshëm për asnjë moment nuk do ta largojë ahiretin nga mendja; ai është vendi i arritjes së tij të fundit, prandaj duke e shikuar ujin, zjarrin dhe të tjerat në hamam nxjerrë mësim.

Njeriu i shikon gjërat nga pikë-vështrimi i profesionit të vet. Kur tregtari i shtofit, zdrukthëtari, muratori apo endësi të hynë në objekt të përfunduar e të mobiluar, do të shohësh se tregtari i shtofit do të shikojë gjithë shtofin aty, endësi do tëshikojë qilimat dhe thurjet tjera, zdrukthëtari do të shikojë trajtat dhe si janë punuar ato, muratori do të shikojë muret dhe si ato janë punuar; dhe njëjtë, ai që ndjekë rrugën e ahiretit, në gjithçka që shikon dhe sa herë që shikon, do të kërkojë mësim dhe kujtim në ahiret.

Kur shikon në të zezë do ta kujtojë terrin në varr, kur sheh gjarpurin do t'i kujtojë gjarpërinjtë e xhehenemit, kur sheh fytyrë të shëmtuar do ta kujtojë *zebanin*, kur dëgjon zë të frikëshëm do ta kujtojë fryerjen në Sur nga Israfilu a.s.. Kur sheh diçka të bukur do t'i kujtojë bukuritë e xhennetit, kur në shitore, treg apo shtëpi të dëgjojë fjalë pranimit ose refuzimit do ta kujtojë atë që vjen pas Ditës së gjykimit, dhe a do jetë ai vet i pranuar apo i refuzuar. Mendime të këtilla duhet ta preokupojnë të mençurin. Angazhimi me obligimet e dynjasë nuk do të duhej ta largojë nga një mendim i tillë, sepse po ta krahasonte kohën e qëndrimit në këtë botë dhe në botën tjetër, do t'i jepte më pak rëndësi kësaj bote, përpos nëse është nga ata që zemrat i kanë gafil dhe nuk janë largpamës.

8. Kur hyn në hamam, nuk jep selam, e nëse dikush i jep këtij, nuk përgjigjet por heshtë që të shohë a përgjigjet tjetri, ose thotë: *"T'u bëftë shëndet (Afkallah)!"* I lejohet t'i zgjasë dorën atij që hyn e t'i thotë *afkallah*. Në hamam nuk flet shumë dhe nuk lejohet leximi i Kur'anit, pos në vete. Nuk ka pengesë që me zë ta thotë *e'udhu*-në. Është e papëlqyer të hyjë në hamam në kohën afër akshamit, dhe mes akshamit e jasisë sepse kjo është koha kur shejtanët përhapen.

9. Lejohet që tjetri t'ia fërkojë shpinën. Tregohet se Jusuf b. Esbat kërkoi që ta fërkojë një person që nuk ishte shok i tij, e pat thënë: *"Ai një herë më pat bërë masazh në hamam, dhe unë dua ta shpërblej, sepse do të gëzohet shumë."*

E leje për masazh gjejmë edhe në këtë transmetim, ku njëri nga as'habët tregon:

“Resulallahu s.a.v.s., ishte në udhëtim, dhe u vendos në një shtëpi. U shtri në bark, e një skllav zezak ia masazhonte shpinën. I thashë:

- Çfarë është kjo, ja Resulallah?!; e u përgjigj:

*- **Deveja më rrëzoi nga shpina.**”⁵³*

10. Menjëherë pas përfundimit të përdorimit të hamamit, duhet të falënderojë Allahun Teala për atë mirësi. Njerëzit e kanë zakon të thonë:

“Uji i ngrohtë në dimër është mirësi që kërkohet.”

Ibn Omeri r.a., ka thënë:

“Hamami është mirësi që u paraqit më vonë.”

Këto janë çështjet fetare që kanë të bëjnë me hamamet, e sa për anën mjekësore, hamami e mbronë njeriun nga sëmundjet e lëkurës. Është thënë që e largon sarillëkun me temperaturë, shkëlqen ngjyrën e njeriut dhe shton fuqinë seksuale. Është thënë se urinimi në këmbë dimrit është më i dobishëm se marrja e ilaçit. Gjithashtu, është thënë që fjetja verës pas hamamit vlen sa edhe marrja e ilaçit, ndërsa larja e këmbëve me ujë të ftohtë pas daljes nga hamami, është e mirë kundër dhimbjes së eshtrave. Nuk është mirë që uji i ftohtë të hedhet në kokë ose të pihet kur del nga hamami. Këto janë për meshkujt.

⁵³ Taberani nga Omeri r.a.

Sa për femrat, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Burrit nuk i lejohet që gruan e tij ta dërgojë në hamam, as në banjo të nxehtë”⁵⁴,

dhe dihet:

“Meshkujve ju ndalohet hyrja në hamam, përpos me mbështjellës, e edhe grave u ndalohet hyrja në hamam, përpos nëse është në periudhën pas lindjes ose është e sëmura.”⁵⁵

Hazreti Ajsha r.anha., hyri në hamam për shkak të sëmundjes nga e cila vuante. Nëse gruas i duhet të hyjë në hamam, atëherë duhet të veshë mantel të gjatë.

Është e papëlqyer që mashkulli t’i paguaj gruas për hamam, sepse kjo nënkupton që po e përkrahë në diçka që është e papëlqyer.

⁵⁴ Do ta përmendim më vonë, kur të flasim për hadithin e radhës dhe pikëpamjet e ndryshme

⁵⁵ Nesai dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm, e nga Xhabiri: **“Kush beson Allahun Teala dhe botën tjetër le të hyjë në hamam vetëm me mbështjellës. Kush beson Allahun Teala dhe botën tjetër mos ta fusë gruan e vet në hamam”.**

Hakimi shënon nga Ajsha r.anha:

“Hamami u është ndaluar grave të ummetit tim”,

dhe e konsideron të besueshëm. Ebu Davud dhe Ibn Maxhe nga Abdullah ibn Omeri:

“Meshkujt le të hyjnë në hamam vetëm me mbështjellës, e grave tuaja ndalohet hyrjen aty, përpos nëse janë të sëmura ose pas lindjes.”

PAPASTËRTIA E PJESËVE TË TRUPIT

Edhe këto janë tetë:

1. *Flokët.*

Nuk pengon rruajtja e kokës për pastërti, njëjtë qysh nuk pengon lëshimi i flokëve, lyerja dhe krehja, përpos nëse bëhen tufë, siç bëjnë ata që dallojnë në shoqëri, ose të lihen balluke që të theksohet status i caktuar, me çka dallohen vetëm disa. Nëse dikush nuk ka ndonjë status në shoqëri, lëshimi i ballukeve do të ishte vetëm lavdërim dhe dyfytërsi.

2. *Mustaqet.*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Shkurtoni mustaqet!”, e në transmetim tjetër:

“Shkurtoni mustaqet ashtu që të jenë rreth buzës, e lëshojeni mjekrën!”⁵⁶

Në hadith është përdorë shprehja ***huffu*** përkthyer si ‘*të jenë rreth buzës*’, që do të thotë edhe: të rrumbullaksohet diçka, siç thuhet në ajetin kur’anor:

“Do t’i shohësh engjëjt e tubuar rreth Arshit.”

39-Zumer: 75

Në një transmetim është përdorur shprehja ***uhfu*** që mund të nënkuptojë prerjen e plotë të mustaqeve, deri sa shprehja ***haffu*** nënkupton shkurtimin.

⁵⁶ Hadith *muttefekun-alejhi* nga Ibn Omeri. Në formën e parë e shënon Imam Ahmedi, e në të dytën Muslimi, nga Ebu Hurejre.

Allahu Teala thotë:

“Sikur ta kërkonte prej jush tërë pasurinë me këmbëngulje, ju do të bëheshit koprracë”

47-Muhammed: 37,

pra, do t’ju ngushtonte dhe vështirësonte.

Askund në transmetime nuk përmendet se as’habët kanë rruajt mustaqet. Por transmetohet që i kanë shkurtuar afër rrojës. Tregohet se njëri nga taibinët e panjë person që kishte shkurtuar mustaqet në këtë mënyrë, e i tha:

“Më kujtove as’habët e Resulallahut s.a.v.s.”

Mugira b. Shu’b ka thënë:

“Resulallahu s.a.v.s., më shikoi, e mustaqet i kisha të gjata. Më thirri e më tha:

- Eja e shkurtomi mustaqet, por jo si tuat.”⁵⁷

Lejohet të lihen mustaqet më të gjata në skaje. Kështu vepronte Omeri r.a., dhe të tjerë, sepse ashtu nuk mbulohet goja, e as nuk ngjiten mbetjet e ushqimit.

Fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

‘lëshojeni mjekrën!’

nënkuptojnë: rritni dhe zgjatni ato. Në një transmetim përmendet që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Çifutët lëshojnë mustaqet dhe shkurttojnë mjekrën. Ju bëni ndryshe nga ata!”⁵⁸

⁵⁷ Shënojnë Ebu Davudi, Nesai dhe Tirmidhiu në *esh-Shemal*.

⁵⁸ Imam Ahmedi nga Ebu Umame, ku vazhdohet: *“Ne thamë:*

Dijetarët le të tregojnë se është e papëlqyer (*mekruh*) të rruhet mjekra, duke e konsideruar këtë bidat.

3. *Qimet nën sjetull.*

Është mirë që, çdo katërdhjetë ditë të ndukë qimet dhe të rruhet. Ndukja është e lehtë dhe e thjeshtë për atë që në këtë mësohet qysh nga fillimi. Mjafton edhe rruajtja për atë që është mësuar me rruajtje, sepse ndukja shkakton dhimbje, e qëllimi këtu është pastrimi dhe largimi i papastërtisë e i erës së rëndë, e krejt kjo arrihet me rruajtje.

4. *Qimet në vendet e turpshme.*

Është mirë të pastrohen me mjete të pastrimit ose me rruajtje, së paku një herë në katërdhjetë ditë.

5. *Thonjtë.*

Është mirë të shkurtohen për shkak të pamjes së shëmtuar të thonjve të gjatë, nga fëlliqësia që mblidhet nën ta. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“O Ebu Hurejre! Shkurtoi thonjtë, sepse shejtani rri në thonjtë e zgjatur.”⁵⁹

- *ja Resulallah! Pasuesit e Librit (ehlul-kitab) i shkurtojnë qimet në majë të mjekrës dhe i lëshojnë mustaqet më të gjata në qoshe; e Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- *Shkurtoni fundin e mustaqeve, lëni qimet në majë të mjekrës dhe bëhuni ndryshe nga pasuesit e Librit!*

Unë them se kjo ishte praktikë e adhuruesve të zjarrit (*mexhuzi*). Ibn Hibban shënon nga Ibn Omeri: *Mexhuzitë i lëshonin fundet e mustaqeve e i rruanin mjekrat. Bëhuni ndryshe nga ata!*

⁵⁹ Hatibi nga Xhabiri.

Nëse nën thonj ka papastërti, kjo nuk e pengon abdesin, sepse nuk pengon arritjen e ujit në lëkurë, e gjithashtu tolerohet për shkak të profesionit. Aq më shumë tolerohet te beduinët dhe burrat nga katundi që papastërtia të mblidhet në thonj, bërryla, e në pjesët e epërme të shputave dhe shuplakave. Resulallahu s.a.v.s., iu urdhëroi t'i shkurtojnë thonjtë dhe i qortonte kur shihte papastërti nën thonjtë e tyre, por nuk i urdhëroi të përsërisin namazin. Sikur t'i urdhëronte edhe të përsërisin namazin, atëherë do të ishte ndalesë.

Në libra nuk kam gjetur kurrfarë transmetimesh që flasin për renditjen e prerjes të thonjve, por kam dëgjuar që Resulallahu s.a.v.s., së pari e priste thonin e gishtit tregues të dorës së djathtë dhe përfundonte me thonin e gishtit të madh po të dorës së djathtë. Në dorën e majtë, së pari prente thonin e gishtit të vogël e përfundonte me thonin e gishtit të madh.

Duke menduar për këtë, arrita deri te kuptimi i saj, që tregon se transmetimi për këtë është i besueshëm. Një kuptim i tillë mund të arrihet vetëm me nurin e pejgamberllëkut, e kur dijetarit i mbërrin një lajm i tillë, ai e shqyrton me mendje.

Ajo që mua më erdhi në mendje, e Allahu Teala e di më së miri, është që duhet prerë thonjtë e duarve dhe të këmbëve. Pasi që dora është më me vlerë se sa këmba, prerja e thonjve fillon me thonjtë e duarve. Dora e djathtë është më me vlerë se sa e majta, prandaj fillohet me prerjen e thonjve të dorës së djathtë.

Në dorë ka pesë gishta, e gishti tregues është më me vlerë se të tjerët, sepse me të bëhet isharet në dy shehadete, prandaj fillon me prerjen e thonit të gishtit tregues, e pastaj me thonjtë e gishtave në anën e djathtë të gishtit tregues, sepse secili pastrim në shariat fillon nga ana e djathtë. Nëse vendos pjesën e epërme të dorës në tokë, gishti i madh del në anën e djathtë, e nëse kah toka e kthen shuplakën, atëherë gishti tregues del në anën e djathtë.

E sikur ta linte dorën në pozitë natyrale, shuplaka do të ishte më shumë e kthyer kah toka, sepse dora e djathtë lëvizë kah ana e majtë. Sikur lëvizjen me dorë të djathtë ta zgjasë majtas, deri në fund, atëherë pjesa e epërme e dorës do të vinte sipër, e, ajo që është natyrale, ka përparësi. Nëse do to vendoste dorën mbi dorë, gishtat do të ishin në rrethore, e renditja do të duhej të shkonte në të djathtë të gishtit tregues dhe vazhdon, deri sa të kthehet te i njëjti.

Kështu, fillimi në dorën e majtë do të ishte me thonin e gishtit të vogël, e përfundimi në thonin e gishtit të madh të dorës së majtë. Do të mbetej vetëm gishti i madh i dorës së djathtë, dhe do të prehet edhe ai. Si masë kemi marrë vendosjen e shuplakës mbi shuplakë, që të krijohet rrethi, pra që gishtat të jenë si njerëzit në hallkë, që të theksohet renditja. Kjo pozitë e duarve është më natyrale se sa pozita e shuplakës mbi pjesën e epërme të dorës, apo bashkimi i pjesëve të epërme të dy duarve.

Shkurtimi i thonjve të këmbëve, për mendimin tim, do të duhej të fillojë me thonin e gishtit të vogël të këmbës së djathtë e të përfundojë me thonin e gishtit të vogël të këmbës së majtë, njëjtë si te fërkimi mes gishtave gjatë pastrimit, përpos nëse për këtë gjen ndonjë transmetim. Atë që e thamë për renditje në prerjen e thonjve të gishtave të dorës nuk vlen për prerjen e thonjve në këmbë, sepse në këmbë nuk ka gisht tregues. Gishtat e këmbës trajtohen si një rend, prandaj fillohet nga e djathta. Në këtë rast nuk do të ishte natyrale të vendoset shputa mbi shputë, si te shuplakat e duarve.

Këto detaje, me nurin e pejgamberllëkut, shpalosen në një moment, por neve na nevojitet të mendojmë më gjatë. Përpos kësaj, po të na pyesnin për këtë, në atë moment, ndoshta, kjo nuk do të na kujtohej, por nëse përmendet se si dhe në çfarë renditje këtë e bënte Resulallahu s.a.v.s., atëherë do të na ishte më e lehtë të nxjerrim kuptimin.

Assesi mos mendo që Resulallahu s.a.v.s., nuk ka pasur masë, kritere dhe renditje në veprimet e veta. Në të gjitha punët nga vullneti i tij, e të cilat këtu i përmendëm, ai para veprimit kishte zgjedhje mes një a më shumë mundësive, duke i dhënë përparësi njëres mbi tjetrën. Veprimi i pakontrolluar është veti e kafshëve, ndërsa renditja e veprave sipas kritereve dhe masave të caktuara është veti e evliave.

Sa më shumë që veprimet dhe mendimet e njeriut përputhen me sheriat, aq më shumë pozita e tij do t'i afrohet pozitës së pejgamberëve dhe evliave, e afërsia e tij me Allahun Teala do të jetë më e theksuar. Kjo për faktin se, ai që është afër Resulallahut s.a.v.s., është në afërsi të Allahut Teala. Ai që është i afërt me dikë që është i afërt me ty, ai është në fakt, afër teje. Lusim Allahun Teala që lëvizjet dhe ndaljet tona mos të jenë në dorë të shejtanit, e ai vepron përmes kërkesave tona. Merr mësim në kontrollimin e lëvizjeve nga Resulallahu s.a.v.s., dhe mënyrës se si ai vendoste surme në sy:

“Ai, s.a.v.s., vendoste surmen në syrin e djathtë tri herë, pastaj në të majtin, dy herë. Fillonte me syrin e djathtë, sepse ai është më me vlerë.”⁶⁰

Pabarazia në numrin e vendosjes së surmes lajmërohet për shkak që, në fund të arrihet numër tek, sepse numri tek është më me vlerë se ai çift. Allahu Teala nuk ka çift, dhe e do numrin tek. Prandaj njeriu duhet gjithmonë të tentojë të përshtatë veprimin e vet me cilësitë e Allahut Teala. Për këtë preferohet numri tek edhe te *istinxa*. Te vendosja e surmes, nuk është kufizuar me tri herë sepse syrit të majtë i ka hije vendosje e surmes një herë, por me një herë nuk do të mund të mbulohen qerpikët me surme. Në syrin e djathtë ka vendosur surmen tri herë që t'i japë përparësi dhe të ketë numër tek, e pasi që e djathta është më e mirë, kuptohet që në të surmeja tërhiqet më shumë.

⁶⁰ Taberani, nga Ibn Omeri, me zinxhir jo të besueshëm të transmetuesve

Dikush mund të thotë:

“Pse Resulallahu s.a.v.s., vetëm dy herë vendoste surme në syrin e majtë, kur dyshi është numër çift?”

- ashtu duhet të jetë, sepse dy numra tek japin një çift, dhe po të tërhiqte surmen në të dy sytë në numër tek, do të përfundonte me numër çift. Resulallahu, s.a.v.s., kujdesej që numri i përgjithshëm të jetë tek.

E përpos kësaj, transmetohet edhe se Resulallahu s.a.v.s., tërhiqte surmen nga tri herë në secilin sy, përshtatshëm abdesit. Kjo është në hadith *sahih*, dhe kësaj i jepet përparësi. Por, sikur të hulumtoja detajet e asaj për të cilën Resulallahu s.a.v.s., kishte kujdes në veprimet e tij, do të shkonim larg. Prandaj, atë që e dëgjove aplikojë edhe në atë që nuk e ke dëgjuar.

Dije se dijetari nuk do të jetë pasardhës i Resulallahut s.a.v.s., përpos nëse nuk njoftohet me të gjitha hollësitë e shariatit, ashtu që mes tij dhe Resulallahut s.a.v.s., të mbetet vetëm një gradë, ajo e pejgamberllëkut, dhe kjo është ajo çfarë e ndanë trashëgimtarin nga e i trashëguari. I trashëguari me punën dhe mundin e tij fiton pasuri, e ajo pasuri kalon në pronë të trashëgimtarit, pa punë dhe mund të tij. Kuptimet e thella së pari i kuptojnë pejgamberët, e pasi që pejgamberët tregojnë për to, mund t'i kuptojnë edhe dijetarët, që janë trashëgimtarë të pejgamberëve.

6. e 7. Prerja e kërthizës dhe synetia.

Teprica e kordonit të kërthizës largohet menjëherë pas lindjes, e sa për synet: çifutët bënin synetinë në ditën e shtatë pas lindjes. Prandaj veprimi ndryshe dhe shtyerja e atij veprimi deri sa fëmijës të nisin t'i rriten dhëmbët do të ishte më i mirë dhe më i sigurt,.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Synetia për meshkujt është sunnet, e për gratë veprim i lavdëruar.”⁶¹

Nuk duhet tepruar (në largim) nëse femra bëhet synet, sepse Ummu Atijjes, që bënte gratë synet, Resulallahu s.a.v.s., i tha:

“Oj Ummu Attije! Bëhu e kujdesshme dhe mos e tepro (mos largo shumë), sepse kjo është më mirë për turpin e gruas dhe më e pranueshme për burrin (gjatë marrëdhënies intime).”⁶²

Në këtë hadith shohim se si Resulallahu s.a.v.s., kujdeset për interesin në ahiret dhe në dynja. Ani pse nuk dinte të lexojë e të shkruajë, Resulallahu s.a.v.s., këto gjëra i kishte të njohura, e nëse diçka prej kësaj injorohet, mund të sjellë dëm. Hamd Allahut Teala, i Cili e dërgoi si mirësi botëve, që t’ju përmbushë interesat e kësaj bote dhe të botës tjetër. Salat dhe selam qoftë mbi të.

⁶¹ Ahmedi dhe Bejhekiu nga Ebu Melih ibn Usame.

⁶² Hakimi dhe Bejhekiu nga Dahhak b. Kajs.

8. *Teprica e mjekrës.*

Për këtë do të flasim tash, që ta bashkojmë me pjesën për mjekrën, sunnetet dhe bidatet për të, sepse ky është vendi dhe rasti më i përshtatshëm. Ulemaja ka mendime të ndryshme sa i përket gjatësisë së mjekrës. Disa thonë se ajo që personi mund të kapë me dorë është gjatësi e mjaftueshme, e ajo që del përtej kësaj duhet shkurtuar. Kështu vepronte Abdullah Ibn Omeri dhe shumica nga as'habët, e edhe esh-Sha'b dhe Ibn Sirin e konsideronin këtë veprim të lavdëruar, deri sa Hasan Basriu dhe Katade e konsideronin të papëlqyer. Ata kanë thënë që më mirë është të mos shkurtohet mjekra, sepse Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Lëshoni mjekrat!”

Nëse nuk e mbulon tërë fytyrën, ky urdhër është më i përshtatshëm. Në të kundërtën, mjekra shumë e gjatë mund të ndryshojë pamjen e jashtme dhe ta bëjë të shëmtuar, e me këtë t'ju hapë gojën kritikuesve. Prandaj, nuk ka pengesë që të shkurtohet mjekra, me këtë qëllim. Ibrahim Nehai ka thënë:

“Habitem me të mençurin që ka mjekër, pse nuk e shkurton, e t'i jetë as e gjatë, e as e shkurtë, sepse mesatarja është e dëshiruar dhe e mirë, në gjithçka.”

E dikush ka thënë:

“Sa më e gjatë mjekra, më e shkurtë mendja.”

PËR MJEKRËN

Mjekra mund të ketë dhjetë cilësi të papëlqyera, disa më shumë se tjerat. Është e papëlqyer të ngjyrosët mjekra me ngjyrë të zezë a të bardhë, të ndukë qimet e thinjura nga ajo, ta shkurtojë ose rrisë dhe ta krehë me qëllim që t'i tërheq vëmendjen dikujt, ta lë të çrregullt për ta paraqitur si të devotshëm, ta theksojë ngjyrën e saj të errët duke admiruar rininë ose thinjat e saj që të tregohen vitet e shumta. Gjithashtu, është e papëlqyer të ngjyrosët mjekra me ngjyrë të kuqe apo të verdhë që të theksohet ngjashmëria me robët e mirë (*salih*) të Allahut Teala.

1. *Ngjyrosja e mjekrës me ngjyrë të zezë* ndalohej, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Më të mirët nga të rinjtë tuaj janë ata që imitojnë të vjetrit tuaj (në autoritet dhe reputacion), e më të këqijtë nga të vjetrit tuaj janë ata që imitojnë të rinjtë tuaj.”⁶³

Pra, të mirë janë ata të rinj që imitojnë të vjetrit në autoritet e reputacion, e jo në ngjyrën e bardhë të mjekrës dhe flokëve. Resulallahu s.a.v.s., *e ka ndaluar ngjyrosjen e mjekrës me ngjyrë të zezë,*⁶⁴

⁶³ Taberani.

⁶⁴ Ibn Sa'd në *et-Tabekat*, nga Amr ibn el-As, me zinxhir të këputur. Shënon edhe Muslimi, nga Xhabiri:

“Ndryshojeni ngjyrën, por mos i ngjyrosni të zeza!” Këto fjalë Resulallahu s.a.v.s., i tha kur i pa qimet e zbardhura te Ebu Kuhafes.

si edhe ka thënë:

“E zeza është ngjyra e banorëve të xhehenemit.”⁶⁵

Në transmetim tjetër thuhet se *ngjyrosja me të zezë është ngjyrosje e banorëve të xhehenemit.*

Në kohën e hazreti Omerit r.a., një person u martua, dhe u ngjyros me të kuqe. Kur ngjyra iu hoq dhe iu shfaqën qimet e thinjura, familja e gruas iu ankua Omerit r.a., prandaj ky e prishi martesën e tyre dhe urdhëroi ta godasin me kamxhik. Atij i tha:

“I mashtrove njerëzit duke u shfaqur si i ri dhe duke i fshehur qimet e thinjura.”

Tregohet se Faraoni, Allahu e mallkoftë, ka qenë i pari që është ngjyrosur me të zezë. Ibn Abbas r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Në ahir-zaman do të ketë njerëz që do të ngjyrosen me të zezë, sikur gushë e pëllumbave. Ata nuk do ta nuhasin aromën e xhennetit.”⁶⁶

2. *Ngjyrosja me të verdhë ose të kuqe lejohet, me qëllim që gjatë luftës, të fshehen thinjat para pabesimtarëve. Megjithatë, nëse qëllimi është për të imituar të devotshmit, atëherë ai veprim është i papëlqyer. Resulallahu s.a.v.s., thotë:*

“Ngjyra e verdhë është ngjyra e myslimanëve, ngjyra e kuqe është ngjyra e besimtarëve (mu'min).”⁶⁷

⁶⁵“...është ngjyra e pabesimtarëve”, e shënon Taberani dhe Hakimi nga Ibn Omeri. Ibn Ebu Hatim thotë se është *munker*.

⁶⁶ Ebu Davudi dhe Nesai nga Ibn Abbasi.

Për ngjyrosjen me të kuqe përdornin këna, e për të verdhën, përzierjen e një flete bari të quajtur *kytym*. Disa nga ulematë ngjyroseshin me të kuqe për xhihad, dhe në këtë nuk ka asgjë të keqe, përderisa nijeti është i sinqertë.

3. *Ngjyrosja e mjekrës me të bardhë* me qëllim që të theksohen vitet e gjata, të fitohet respekt mes njerëzve, t'i pranohet dëshmia e tij, t'i besojnë tregimet e tij, ta nënçmojë rininë e të shfaqë dituri e mësim, i bindur se vitet sjellin mësim. Larg qoftë! Për të të padijshmit, vitet veç sa ia shtojnë paditurinë. Dituria është produkt i mendjes. Ajo është çështje e natyrës dhe në këtë qimet e bardha nuk kanë ndikim. Prandaj, ai që prej natyrës është budalla (*ahmak*), vitet e gjata vetëm sa ia vërtetojnë këtë. Shehlerët e mëhershëm i jepnin përparësi të rinjëve, sipas ditorisë së tyre. Omer ibn Hattab r.a., i jepte përparësi të riut Ibn Abbas ndaj as'habëve më të vjetër, dhe atë e pyeste. E, vet Ibn Abbas r.a., pat thënë: "*Vetëm të riut Allahu Teala ia jep diturinë. Çdo e mirë është në rini*", e më pas lexoi ajetet:

"Dëgjuam një djalosh që i përqeshte ata, quhej Ibrahim." 21-Enbija: 60,

"Ata ishin djelmossa që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcua në rrugën e drejtë." 18-Kehf: 13, dhe

"Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri."

19-Merjem: 12

⁶⁷Taberani dhe Hakimi, por në njëjës, nga Ibn Omeri. Ibn Ebu Hatim thotë që ky është hadith *munker*.

Enesi r.a. tregon:

“Resulallahu s.a.v.s., kur kaloi në ahiret, në kokën dhe mjekrën e tij nuk ishin as njëzet qime të bardha.”

- *O Ebu Hamza! Po ai veç ishte plakur!,*

i tha dikush, dhe Enesi r.a. tha:

- *Allahu Teala nuk e turpëroi me qime të bardha.*

- *A është e metë kjo?!,*

pyetën, e Enesi ju tha:

- *Të gjithë e mohoni!*⁶⁸

Jahja ibn Ekrem u bë kadi në Basra kur ishte njëzet e një vjeçar. Për ta turpëruar, në një fshat e pyetën:

- *Sa vjet i ka kadia i nderuar, Allahu Teala e ndihmoftë?,*

e Jahja u përgjigj:

- *Aq sa i kishte Attab ibn Esed kur Resulallahu s.a.v.s., ia besoi sundimin e Mekës dhe e bëri kadi, dhe me aftësinë e tij i heshti të gjithë.*

Tregohet se Malikiu, Allahu rahmet i bëftë, ka thënë:

“E kam lexuar në libra: mos të mashtrojë mjekra, se edhe cjapi ka mjekër.”

Ebu Amir ibn Ala ka thënë:

“Kur sheh ndonjë person të gjatë, me kokë të vogël e mjekër të gjerë, llogarite budalla, qoftë ai edhe Umejje ibn Abdishems.”

⁶⁸ Është *muttefekun-alejhi*, nga Enesi, por pa pjesën: *“a është e metë...”*

Ejjub Sahtijani ka thënë:

“E kam parë një plak tetëdhjetë vjeç si e pasonte një të ri e mësonte nga ai.”

Ali ibn Husejn ka thënë:

“Kush di më shumë në një çështje, ai ka përparësi, qoftë edhe më i ri se ti.”

U pyet Ebu Amr ibn Ala:

- *A i ka hije më të vjetrit të mësojë nga më i riu?*

- *Nëse padituria është cilësi e shëmtuar e të vjetrit, atëherë mësimi nga i riu është diçka që e zbukuron njeriun.*

Jahja ibn Mein e pa Ahmed ibn Hanbelin si ecë pas mushkës së Imam Shafiut. I tha:

- *O Ebu Abdullah! Ti e braktise mbledhjen e haditheve nga Sufjani (ibn Ujejne), e po shkon pas mushkës së këtij të riu, dhe atë po e dëgjon;*

e imam Ahmedi iu përgjigj:

- *Po të ishe i udhëzuar, edhe ti do t'i shkoje pas kësaj mushke. E, ajo çka më ikë prej Sufjanit, prapë do të vijë tek unë, me një zinxhir pak më të gjatë, por nëse më ikë mençuria e këtij të riu, atë nuk e arrij ta përfitoj nga transmetuesit, as me zinxhir të shkurtë, as të gjatë.*

4. *Ndukja e qimeve të bardha që të mos duket i vjetër, gjë që Resulallahu s.a.v.s., e ka ndaluar, duke thënë:*

- ***Ajo është dritë e besimtarëve.***

Ajo që thuhet për ngjyrosjen e qimeve të bardha me ngjyrë të zezë vlen edhe për ndukjen e qimeve të bardha, për arsyet që i përmendëm. Qimet e bardha janë dritë hyjnore, prandaj largimi i tyre do të thotë largim i atij nuri.

5. *Ndukja e qimeve për argëtim* është e papëlqyer sepse ndryshon pamjen natyrale. Ndukja e qimeve nën buzë është bidat. Para Omer ibn Abdulazizit dëshmonte një person që i kishte ndukë qimet në këtë mënyrë, prandaj Omeri e refuzoi dëshminë e tij. Edhe Omer ibn Hattab r.a., dhe Ibn Ebu Lejla refuzonin dëshminë e atyre që rruajnë mjekrën në këtë mënyrë. E sa për ndukjen e qimeve në rrënjë, me qëllim që t'i ngjajë djalit të ri me fytyrë pa mjekër, kjo është vepër shumë e keqe. Mjekra është zbukurim i mashkullit. Allahu Teala ka melekë që betohen:

“Pasha Allahun, që njeriun e zbukuroi me mjekër (që nga krijimi).”

Në *Garibut-Te’vil* thuhet se në ajetin e Kur’anit:

“Ai shton në krijim atë që do” 35-Fatir: 1,

me shprehjen *‘shton’*, qëllim është mjekra.

Shokët e Ahnef ibn Kajs kanë thënë: *“Kemi aq shumë dëshirë, po të ishte e mundur, t’ia blejmë një mjekër Ahnefit, qoftë edhe për njëzet mijë.”*

Shurejh Kadi ka thënë: *“Do të jepja dhjetë mijë dërhëmë për të pasur mjekër.”*

E si mund të nënçmohesh mjekrën kur ajo ngritë njeriun? Mjekra tregon diturinë, respektin dhe vendin e posaçëm në takime, mjekra tërheq shikimet, ka përparësi në xhemat, e ruan nderin dhe respektin. Është thënë:

“Banorët e xhennetit do të jenë pa mjekra, përpos Harunit, vëllaut të Musait a.s.. Ai do të ketë mjekër deri në kërthizë, si nderim ndaj tij.”

6. *Shkurtimi, rregullimi e përmirësimi i mjekrës*, për dukje më të mirë para grave. Ka’b ka thënë:

“Në ahir-zaman do të ketë njerëz që do të shkurtojnë mjekrat e ta rregullojnë që të jenë si bishti i pëllumbeshës, e këpucët do t’i bëjnë në formë të drapërit. Ata nuk do të kenë kurrfarë të mirë.”

7. *Lëshimi i mjekrës tej mase*, d.m.th, të lëshojë flokët nga zylyfët e t’i bashkojë me mjekrën ashtu që lëshohen deri në gjysmë të fytyrës. Këso pamje nuk i kanë hije njerëzve të mirë.

8. *Krehja e mjekrës për të tjerët*. Bishr ka thënë:

“Te mjekra dy herë bëhet dyfytyrësi (rija): kur e krehë për të tjerët, ose e lë të çrregulluar për të treguar devotshmërinë.”

9. e 10. *Të shikohet mjekra e zezë ose e bardhë me mburrje e admirim* është e papëlqyer, njëjtë si për pjesët tjera të trupit, bile edhe në të gjitha veprimet dhe sjelljet tjera, për çka do të flasim më vonë.

Kjo është çka deshëm të themi për llojet e zbukurimit dhe pastrimit. Nga hadithet që i përmendëm prej Ajshes r.anha., Ibn Abassit dhe Ebu Hurejres, në lidhje me trupin paraqiten 12 sunnete.

Prej tyre, pesë kanë të bëjnë me kokën:

Pastrimi dhe krehja e flokëve, shpërlarja e gojës, shpërlarja e hundës, shkurtimi i mustaqeve dhe përdorimi i misvakut.

Tri prej tyre kanë të bëjnë me duart dhe këmbët:

Shkurtimi i thonjve, larja e nyjeve të gishtave, dhe pastrimi i nyjeve të këmbëve.

Katër kanë të bëjnë me të gjithë trupin:

Largimi i qimeve nën sqetull, rruajtja e qimeve në vendet e turpshme, synetia, dhe pastrimi pas kryerjes së nevojës e urinës.

Për të gjitha këto ka transmetime. Pasi qëllim i këtij libri ishte pastërtia e jashtme, do të ndalemi këtu. E ti dije mirë se papastërtia e brendshme (*batin*) që duhet të largohet është shumë më e madhe. Me ndihmën e Allahut Teala do të flasim edhe për këtë, e aty do të shpjegojmë mënyrat e largimit të atyre papastërtive si edhe pastrimin e zemrës.

Vetëm Allahut i takon falënderimi, salat dhe selam Muhammedit s.a.v.s., ehli bejtit, as'habëve dhe secilit mysliman të devotshëm.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	3
RRETH PASTRIMIT NGA PISLLËQET	15
AJO QË LARGOHET ME PASTRIM	15
MJETET PËR PASTRIM	17
MËNYRAT E LARGIMIT TË PAPASTËRTISË	24
PASTRIMI NGA GJENDJET E PAPAstra.....	25
RREGULLAT GJATË KRYERJES SË NEVOJËS	25
PASTRIMI PAS NEVOJËS SË MADHE	28
ABDESI.....	31
TË PAPËLQYERA (MEKRUH) TË ABDESIT	39
FAZILETI (VLERA E LARTË) E ABDESIT	41
MËNYRA E BËRJES GUSUL (LARJES)	45
MËNYRA E TEJEMMUMIT	47
PAPASTËRTIA E Pjesëve të trupit	49
PAPASTËRTIA DHE LAGËSHTIA E NGJITUR	49
SUNNETET E QËNDRIMIT NË HAMAME	57
PAPASTËRTIA E Pjesëve të trupit	62
PËR MJEKRËN	72

